



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:022025

Datë: 20.01.2021

Numri i dokumentit: 01425488

**PKR. nr.11/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda, Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës parë**, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarit Aziz Shaqirit – kryetar i trupit gjykues si dhe gjyqtarëve : Veli Kryeziu dhe Rilind Sermaxhaj – anëtarë të trupit gjykues, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të akuzuarit R. L. nga fshati Hogosht, Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës, ( në tekstin e mëturjeshëm KPRK-s ), të cilin sipas autorizimit e mbrojnë av. Adi Dinaj nga Prishtina, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr. 216/2014 të datës 17.12 të vitit 2014, të cilën e përfaqësoi prokurori i shtetit Mr. Sc. Isuf Sadiku , pas mbajtjes së shqyrtimit të fundit gjyqësor dhe publik më datën 09 nëntor të vitit 2020, mori dhe në prani të prokurorit të shtetit dhe të të akuzuarit e në mungesë të mbrojtësit të autorizuar, në të njëjtën ditë publikisht shpall këtë,

**A K T G J Y K I M**

**I. I akuzuari R. L.** nga babai B. dhe e ëma N. – me mbiemër të vajzërisë k., i lindur më 15.09 1964 në fshatin Hogosht, Komuna e Kamenicës, me profesion gjeolog pasi që ka të kryer Fakultetin e Gjeologjisë por edhe ka arritur titullin shkencor magjistër i shkencave teknike, përgjegjës i Inspektoratit Komunal në Kamenicë nga data 25 prill 2014, kurse nga muaji prill të vitit 2000 ka qenë inspektor komunal i resurseve natyrore, baba i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje ekonomike të mesme, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, i tërhiqet vërejtja se nëse eventualisht e ndërton vendbanimin e tij është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën personalisht, apo përmes mbrojtësve të tij gjer në përfundim të procedurës penale lidhur me këtë çështje penale, nën kërcënim të pasojave ligjore,

**Ë s h t ë f a j t o r**

**sepse**, gjatë periudhës kohore 2013-2014, në cilësi të personit zyrtar – edhe atë të inspektorit komunal të resurseve natyrore gjer më datën 24 prill 2014 në Kamenicë, e pastaj nga data 25 prill 2014 e tutje në cilësi të përgjegjës të Inspektoratit Komunal në Kamenicë, me qëllim që vetit përkatësisht tjetrit t'i sjell dobi pasuore në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi ka keqpërdor pozitën përkatësisht autoritetin zyrtar, në atë mënyrë që në forma të ndryshme ka ndihmuar duke ju dhënë instrukcion personave të kompanive për eksploatimin e rërës dhe zhavorit edhe atë SHPK “ I. Komerce “ me seli në Muçivrcë, Komuna e Kamenicës, përmes bisedave telefonike me telefonin e tij me SIM karte 044 ..... me dëshmitarin Sh. Th. – person përgjegjës në këtë kompani, posedues i telefonit mobil me SIM

kartelet 044 ..... me përmbajtje : “ **boja një kopje qati dosti duke i thënë ngom mua çka po të thom dhe i tregon duke i thonë – le t’i thotë se ajo ka vlej për ata që skan fare licenca, mos i treo që të kam que unë, edhe e sugjeron duke i thënë qato letrat boni patjetë, dëshmitari Sh. Th. përgjigjet “ po, po veç të nerërmën në mëngjes se sot nuk mundem “**, pastaj i akuzuari vazhdon dhe i thotë Sh. Th. “ qato letra me sabah i banë me vete dhe u bitis, njëherit i thotë se kur të vij në ata mos u dorëzo i thu që unë i kam pi doganës, pra kur të vij në ata ja qet letrat dhe i thi që i ke prej doganes për neve, në fund i thotë “ shtrëngov njëherë tani “, e sipas raportit policor të datës 08.07 2014 policia e ka ndal automjetin transportues Man me targa të regjistrimit 629 KS 127 të ngarkuar me 15 metra kub zhavor, të cilin e ka drejtuar dëshmitari Sh. Th. dhe pas prezentimit të dokumentacionit për transportimin e këtij zhavori edhe pse i njëjti nuk ka qenë valid, e ka liruar i akuzuari R. L. duke e keqpërdor pozitën përkatësisht autoritetin e tij zyrtar si inspektor komunal edhe pse e ka ditë se ky dokumentacion nuk është valid, sepse i njëjti është siguruar sipas instruksioneve të tij, e këtë e vërteton edhe dëshmitari Sabri Thaçi tek i cili është dorëzuar ky zhavor, me **arsyetim të Sh. Th. se kinse do t’ia siguroj dokumentacionin valid nga kompania “ A. D. “ mirëpo këtë nuk e ka bërë**. Pastaj sipas transkriptit të bisedës telefonike mes të akuzuarit dhe Sh. Thaçit më datën 03.07 2014 i akuzuari e ka pyetur dëshmitarin Sh. “ **se a kishte kryer diçka punë rreth një muhabeti apo letra të doganës që kishin biseduar më heret duke shtuar shiqo ti nëse mundesh me marrë diçka Bujanovc – Muçivrcë apo ti blej një herë një kamion zall, sa për mi siguru do letra, e pastaj e shftrëzon të njëjtin dokumentacion, duke e sygjerruar se nuk ka lidhje ta kesh një herë dhe i thu se kam blerë praj atij edhe tana shnosh, ... kurse dëshmitari Sh. Thaçi ia ka kthyer përgjigjen “ aha okej flm u kry pra “**, e që rezulton se në rastin konkret i akuzuari R. duke e keqpërdor pozitën përkatësisht autoritetin zyrtar ka vepruar në favor të kompanisë “ Imrani Komerce “ pronar i së cilës është vëllai i dëshmitarit në fjalë A. Th., **duke i sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme në shumën prej 225 Euro ( 15 metra kub x 15 Euro për një metër kub = 225 Euro )** edhe pse kjo kompani nuk ka poseduar dokumentacion valid për eksploatimin dhe transportimin e rërës dhe zhavorit, e me këtë ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02 / 46 të datës 02.11 2011, duke ia shitur djalit të xhaxhait të tij S. Th. nga fshati Muçivrcë. Pastaj, sipas bisedës telefonike mes të akuzuarit R. dhe dëshmitarit Sh. Thaçi të datës 07.07 2014, **i akuzuari R. i ka thënë dëshmitarit Sh. “ ku je shef “ duke e pyetur se ku gjendet kurse dëshmitari Sh. ia ka kthyer “ se dola te A.i dhe jam t’u pi ni kafe “**, e pastaj i akuzuari ka vazhduar “ **se ke t’u i shku kamioni nashta po zalli, ke t’u i shku për ufla “ bile edhe kamioni ka mujt me i shkue, më pas fillon duke qeshur me të madhe, e pastaj i akuzuari e pyet këtë dëshmitar “ se çka bane ti a mujte me kry punë diçka, naj diçka si for,** kurse dëshmitari Sh. ia kthen duke i thënë : **mos po ta kryen naj nja duke i rezervuar, për të vazhduar i akuzuari “ valla ai pshtoj për pak qaj shoqi qata ( duke aluduar në A.in ) më pas dëshmitari i thotë : është burr i mirë e këtioj i përgjigjet i akuzuari duke i thënë “ valla po po mu dasht me qu atje nja të mirë dhe kryti punë deri të ngojnë “ e nga kjo rezulton se i akuzuari R. duke e keqpërdor pozitën përkatësisht autoritetin zyrtar personit me emrin **A. me mbiemër të panjohur për gjykatën** i ka siguruar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme duke mos ia sekuestruar as zhavorin prej 15 metra kub me vlerë prej 225 ( 15 metra kub x 15 Euro për një metër kub = 225 ) Euro, e as kamionin si mjet transportues për shkak të bartjes së materialit inert të ndaluar me vendimin e lartcekur të Qeverisë së Republikës së Kosovës, **e cila sasi me vet faktin që është dashtë të sekuestrohet për të njëjtin personi në fjalë nuk ka poseduar dokumentacion valid, edhe pse me vendimin lëndor të Qeverisë së Republikës së Kosovës është ndaluar në tërësi eksploatimi i materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjëve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, e pa u plotësuar kushtet e Marrëveshjes së bashkëpunimit rreth zbatimit të këtij Vendimi të Qeverisë të lidhur mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror të Republikës së Kosovës, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe OJQ “ Zhavori “ si përfaqësues i operatorëve që eksploatojnë rërë dhe zhavor në territorin e Republikës së Kosovës me nr. të protokollit 1398 të datës 05.04 2012,****

-ashtu që me këto veprime kriminale ka kryer veprën penale **keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1.** të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 21, 41, 45, 73, dhe 74 të KPRK-s, nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale ( KPP ), të akuzuarin,

## E G J Y K O N

**Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë ( 180 ) ditëve**, i cili suspendohet dhe me pëlqimin shprehimisht të dhënë nga ana e të akuzuarit R. L. pas shpalljes së aktgjykimit dënim suspendohet pasiqë i akuzuari në kuptim të nenit 44 të KPRK-s shprehimisht është pajtuar pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 47 të KPRK-s.

**ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë në shumën prej dymijë ( 2,000 ) Euro**, duke u detyruar i njëjti që këtë shumë ta paguaj në katër këste të barabarta prej nga 500 Euro, për katër muaj, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo, në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s, nëse eventualisht i akuzuari R. nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti **do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind ( 100 ) dite**, duke u ekzekutuar në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së ftesës për mbajtjen e dënimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**II.**Në kuptim të nenit 83 paragrafi 1. Të KPRK-s të akuzuarit në fjalë do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar periudha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 24.09 2014 e gjer më datën 19 nëntor të vitit 2014.

**III. DETYROHET** i akuzuari në fjalë që të paguaj në emër të **shpenzimeve të procedurës penale** – për ekspertizën financiare shumë prej **204.40 Euro**, në emër të pjesëmarrjes së ekspertit financiar në arsyetimin e ekspertizës financiar shumë prej **50 Euro**, për **paushallin gjyqësor** shumë prej **150 Euro si dhe në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit shumë prej 50 Euro**, të gjitha në afat prej 15 ditëve, duke filluar nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### 1.Hyrje në arsyetim

PTH-DKR kundër të akuzuarit ka ngritur aktin akuzues lëndor, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar më gjerë në këtë akt akuzues ka kryer veprën penale lëndore.

Akti akuzues me përshkrim faktik dhe kualifikim juridik i ngritur nga organi i ndjekjes penale është me përmbajtje si në vijim :

Se gjatë periudhës kohore 2013-2014, në cilësi të personit zyrtar –në cilësi të inspektorit komunal të resurseve natyrore gjer më 24 prill 2014 në Kamenicë, e pastaj nga data 25 prill 2014 në cilësi të përgjegjës të Inspektoratit Komunal në Kamenicë, me qëllim që vetit apo tjetrit t'i sjell dobi të kundërligjshme pasurore, në vazhdimësi ka keqpërdorur pozitën apo autoritetin zyrtar duke ndihmuar në forma të ndryshme Kompanitë që merren me eksploatimin e rërës dhe zhavorit edhe atë : SHPK “ Imrani Komerce “, “ Xhelali Trans “, “ Besi Com “, “ Agi Dani“, “ Koni Company, “ Kreileva Com“ etj. Në këtë Komunë, duke iu dhënë instruksione për eksploatim ilegal të rërës dhe zhavorit, e duke i udhëzuar që këto Kompani të pajisen me dokumente fiktive doganore si mbulesë për veprimtaritë e tyre ilegale, e të cilat veprimtari janë në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 02/46 të datës 02.11 2011, i cili vendim ndalon në tërësi eksploatimin e materialeve inerte nga shtretëritë, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjëve në gjithë territorin e Kosovës,

-me çka kishte me kryer veprën penale **keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1.** të KPRK-s.

Gjykata Themelore me aktgjykimin e mëparshëm të akuzuarin në fjalë e ka liruar nga akuza për veprën penale lëndore, mirëpo ky aktgjykim është anuluar nga Gjykata e shkallës dytë me vërejtje përkatëse, të cilat janë eliminuara nga trupi gjykues gjatë rigjykimit të kësaj lënde penale.

Vlen të theksohet se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr. 346/2017 të datës 17 prill të vitit 2018 është miratuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshëmërisë e ushtruar nga ana e mbrojtësve të të dënuarit R. L. duke u anuluar aktgjykimi i gjykatës së shkallës parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës dytë dhe çështja penale është kthyer në rigjykim tek gjykata e shkallës parë. Kjo gjykatë ka dhënë këto vërejtje : që gjykata e shkallës parë të administroj të gjitha provat e propozuara si dhe provat tjera të cilat i konsideron të nevojshme për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike e në vaçanti duhet të vërtetohen faktet se si i dënuari këshilloj personat e cekur në aktgjykim që të merren me eksploatimin ilegal të materieve inerte, kush i siguroj dokumentet e DUD-it, me iniciativën e kujt dhe çfarë kontributi ishte i të dënuarit në këtë punë si dhe a ishte i dënuari pjesë e ekipit të përbashkët me policët në terren, kur është lejuar kamionëve që transportonin zhavor që të vazhdojnë rrugën, pasi që më parë nga vozitësit iu kanë prezentuar dokumentet e DUD-it, e më pas të merr një aktgjykim të ligjshëm me arsyet në harmoni me dispozitat e Kodit të Procedurës penale të Kosovës ( KPPK-së ).

Gjykata e shkallës parë gjatë rigjykimit të çështjes penale ka administruar provat e propozuara nga ana e organit të ndjekjes penale por edhe provat tjera të nevojshme të numruara në vazhdim të arsyetimit e sipas vlerësimit të trupit gjykues për ndriçimin e plotë të gjendjes faktike e të cilat do të paraqiten në këtë arsyetim duke u vlerësuar veç e veç por edhe në kontekst me provat tjera.

Gjatë fjalës përfundimtare prokurori i shtetit ka mbet në tërësi pranë akuzës në aktakuzën lëndore edhe atë me përmbajtje si në seancën e shqyrtimit gjyqësor para se lënda penale mu kthyer në rigjykim, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas Kodit Penal, e sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit duhet t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në mënyrë që dënimi të jetë proporcional me shkallën e përgjegjësisë penale por edhe me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lëndore. Përkatësisht në përshkrimin faktik të veprës penale duhet të shtohen fjalët “ A. D. “ kurse pjesa tjetër e fjalës përfundimtare e dhënë nga prokurori i shtetit mbetet në tërësi e pandryshuar.

Mbrojtësi i autorizuar i të akuzuarit av. Avdi B. Dinaj nga Mitrovica ka dorëzuar fjalën përfundimtare me shkrim duke theksuar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë para kthimit të lëndës penale në rigjykim, e të cilën e ka elaboruar përmbajtësisht në seancë në pika të shkurtëra edhe atë si në vijim : nuk është kontestuese se i akuzuari në Komunën e Kamenicës ka punuar si inspektor i resurseve natyrore e më vonë që nga 25.04 2014 si përgjegjës në kuadër të Drejtorisë për shërbime publike në Kamenicë. Nga viti 2010 kompetencat e inspektorit komunal kanë kaluar në kompetencë të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me qendër në Prishtinë. I akuzuari ka qenë i njoftuar me vendimin e Qeverisë së republikës së Kosovës të datës 02.11 2011 lidhur me ndalimin e eksploatimit të materieve inerte nga shtrati, brigjet dhe hapësirat e lumenjëve në territorin e Kosovës. Që këtë vendim të Qeverisë e kanë zbatuar të gjithë inspektorët e po ashtu edhe i akuzuari në fjalë. Në periudhën kohore prej 2011-2014 janë konfiskuar zhavor nga eksploatuesit pa licencë, sasia prej 512 m<sup>3</sup> që ka qenë e vendosur prapa shtëpisë së kulturës në Kamenicë, e që nga viti 2016 është shitur në ankand publik.

Sipas momerandumit nr. 1996 të datës 05.04 2012 Komisioni për Miniera dhe Minerale ka lejuar që subjektet që kanë pas licenca të vazhdojnë aktivitetet e tyre. Nga provat e administruara nuk është vërtetuar se këto subjekte të licencuara në Komunën e Kamenicës i kanë eksploatuar materiet inerte nga shtratit e lumenjve, brigjet e tyre dhe hapësirat afër lumenjëve. Edhe vet dispozitivi i akuzës i ndërtuar në këtë mënyrë është i pa argumentuar në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, meqë nuk është vërtetuar se i akuzuari i ka urdhëruar të sigurojnë dokumente fiktive, e nëse po, cilat janë ato kompani që kanë siguruar dokumentet fiktive, por meqë përgjegjësia penale është individuale, njashu që nëse dikush prezenton dokument fiktiv është dashtë t'ia prezentoj organeve policore për atë që ka kryer vepër penale të falsifikimit, njashu që organi policor është dashur të reagon lidhur me këto dokumente fiktive dhe të vërtetojnë edhe përpiluesin e të njëjtit dokument fiktiv nëse ka ekzistuar, për të zbuluar ekzistimin e veprës penale. Këto kompetenca nuk hyjnë në domenin e veprimeve të të akuzuarit, se në çdo rast kontrollimi i automjeteve me zhavor është bërë në prezencën e së paku tre inspektorëve ku prezent kanë qenë edhe organet policore.

Në dispozitiv theksohet tejkalimi i kompetencave zyrtare – se ka ndihmuar në forma të ndryshme, theksime këto që janë paushalle dhe të paargumentuara nga se duhet vërtetuar dashjen që i akuzuari

vetit apo tjetrit t'i sjell dobi pasurore, se cila është ajo dobi apo dëm të cilin ja ka shkaktuar dikujt e këto nuk janë argumentuar.

Në procedurën e provave janë administruar edhe përgjimet telefonike të cilat kryesisht kanë të bëjnë fjalë me përgjimet e bisedës me pronarin e kompanisë "A. D." – R. V.n. Të gjitha bisedat të cilat kanë qenë të zhvilluara janë të drejtuara me qëllim të sigurimit të 200 m<sup>3</sup> ranë dhe zhavor për ngritjen e një shtalle bagëtishë për Sabri Th., e cila kërkuesë nuk është realizuar asnjëherë, e që vërtetohet edhe me ekspertizën financiare që vërteton rrethanat e veprimtarisë legale të ndërmarrjes "A. D." Sh.p.k. me drejtor R. V.n, se përveç licencës për nxjerrjen e rërës dhe zhavorit është marr edhe me importin e rërës dhe zhavorit nga republika e Sërbisë duke bërë edhe sepertimin e rërës dhe zhavorit. Ekspertizës financiare i është bashkëngjitur i gjithë dokumentacioni përkatës mbi importimin e rërës nga Republika e Sërbisë, si dhe se personave që iu është shitur e kjo vërtetohet edhe me mbrojtjen e të pandehurit të dhënë gjatë gjitha fazave të procedurës, si dhe faktin se edhe përkundër bisedës sipas përgjimeve, Sabri Thaçi nuk është furnizuar me rërë dhe zhavor nga kjo kompani. Po ashtu në përgjigjen e Komisionit të pbaruir për miniera dhe minerale theksohet dhe vërtetohen rrethanat se cilat kompani kanë pasur licenca për eksploatinim – shfrytëzimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorit në regjion, duke i sqaruar edhe veprimet e ndërmarrja në përputhje me vendimin e Qeverisë, inicimin e procedurave penale, administrative ndaj personave për aktivitete të paligjshme dhe nga inspektorati i KPMM në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Inspektorët Komunal, e që në tërësi përputhen me pohimet e të pandehurit të dhëna gjatë procedurës lidhur me këtë çështje penale. Nga vet fakti i mosrealizimit të kërkesës këto përgjime s'kanë pasurë nevojë as që të administrohen nga se nga vet përmbajtja e tyre asgjë nuk ka të bërë me veprimet inkriminuese siç theksohen në akuzë. Mirëpo, sido që të jetë këto përgjime nga vetë origjinalitetit i tyre në asnjë mënyrë nuk guxojnë të interetohen ndryshe, përveç mënyrë që interpretimit nga ana e të akuzuarit, të cilat përgjime në asnjë mënyrë nuk kalojnë në zonën kriminale. Po ashtu është shtuar se mebetet pranë theksimeve në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për çka edhe gjykatës i ka propozuar që në mungesë të provave të akuzuarin ta lirojë nga akuzat konform dispozitave të nenit 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPK-së.

I akuzuari e ka mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij duke kërkuar nga gjykata që në mungesë të provave ta lirojë nga akuzat lëndore.

Trupi gjykues pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor ka vlerësuar me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional edhe atë me përkujdesje të njëjtë si për vërtetimin e fakteve relevante kundër të akuzuarit ashtu edhe në favor të tij gjatë zhvillimit të procedurës penale, edhe atë mbrojtjen e të akuzuarit, dëshmitë e dëshmitarëve, leximit të transkripteve të përgjimit zyrtar, shkresave si prova materiale, fotodokumentacionit përkatës, me dëgjimin – riprodhimin e CD-ve si prova materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor, mendimin dhe konstatimin e ekspertit financiar lidhur me ekspertizën financiare duke përfshirë edhe sqarimet e dhëna nga eksperti në seancë gjyqësore – përfshirë këtu edhe të gjitha aktet shkresore të bashkëngjitura ekspertizës financiare, përgjigjen me shkrim të dhënë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë si dhe aktet tjera shkresore që kanë të bëjnë me raportet shkresore të policëve në terren si dhe aktet tjera shkresore për vazhdimin e licencave sipas Memorandumit të mirëkuptimit dhe vet këtij Memorandumi në këtë lëndë penale me theks të veçantë edhe të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër dhe data si në pjesën e këtij arsyetimi lidhur me provat e administruara, duke nxjerr përfundim logjik dhe ligjor se me këto prova vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari në fjalë në kuptim të nenit 365 të KPPK-s është fajtor dhe përgjegjës penalisht për kryerjen e veprës penale **keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1. të KPRK-s.**

## 2.Administrimi i provave

Trupi gjykues gjatë procedurës së rigjykimit ka administruar provat personale dhe materiale si në vijim :

-mbrojtjen e të akuzuarit R. L., i cili ka theksuar se mbetet në tërësi pranë mbrojtjes së të tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor para se me u kthyer lënda penale në rigjykim dhe vendosje,  
-deklaratën e dëshmitarit Nazif Hajrizi – komandant i Stacionit Policor në Kamenicë,  
-deklaratat e dëshmitarëve : **R. V.** pronar i kompanisë “ A. D. “, Ramiz Spahiu pronar i kompanisë “ Besi Com “ me seli në Muçivrcë, Ramiz Spahiu vëllai i i dëshmitarit Afrim Spahiu për ndryshe pronar i firmës “ Besi Com “ me seli në Muçivrcë, Afrim Spahiu pronar i “ Besi Com “, **Sh. Thaçi** është vëlla i Imran Thaçit pronar i kompanisë “ Imrani comerce “ me seli në Muçivrcë, si dhe **S. Th. djalë i xhaxhat të Sh. Th.**,

-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/46 të datës 02.11 2011 i cili ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit – pra më datën **02.11 2011**,

-Marrëveshje Bashkëpunimi rreth zbatimit të Vendimit të Qeverisë nr. 02/46 të datës 02.11 2011 të lidhur në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale si dhe OJQ “Zhavor “ si përfaqësuese legjitime e operatorëve të eksploatimit të rërës dhe zhavorit **nr. 1396 të datës 05 prill të vitit 2012**,

-njoftimi me shkrim mbi pezullimin e të gjitha eksploatimeve për operatorët e eksplatimit të rërës dhe zhavorit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë nr. 23.2011 të datës 02.11 2011.

-Raporti hetues i datës 08 10 2014,

-Raporti mbi implementimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit përkatësisht përgjimit të telekomunikimeve të datës 14.07 2014 dhe 02.08 2014 si dhe **Transkriptet e bisedave telefonike**,

-Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës SP Kamenicë nr. 2014-SHZ-264 i datës 08.07 2014,

-Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës SP Kamenicë nr. 2013-SHZ-259 i datës 27.09.2013,

-Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës SP Kamenicë nr. 2014-SHZ-279 i datës 13.07 2014.

-Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës SP Kamenicë nr. 2014-SHZ-281 i datës 14.07 2014,

-Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës SP Kamenicë nr. 2014-SHZ-307 i datës 30.07 2014,

-Raportit të Policisë i datës 15.09.2016 me numër të referencës 06/2-04 /183/2016 – Pranim dorëzimi i materialeve të mbledhura nga Njësiti i përgjimit ligjor në DMH lidhur me tërheqjen e materialit të mbledhur në formë digjitale përmes CD lidhur me zbatimin e urdhëresave e për **masën e fshehtë të përgjimit të telekomunikimeve të gjykatës Themelore në Gjilan UGJK nr. 140/14, të bashkëngjitura : 1 CD me incizimet për numrin telefonik përkatës dhe formulari për pranim dorëzimit e dëshmime-provave lidhur me datat kur edhe janë nxjerr transkriptet nga bisedat telefonike mes akterve përkatës – të të akuzuarit R. dhe eksploatuesve të rërës dhe zhavorit, Raporti në lidhje me rastin policor 2014-KE-265 i datës 05.10 2016 si dhe faturat e kompanisë A. D. nga të cilat nuk shihet se rërë dhe zhavor t'i ketë dërguar sipas faturës kompanisë “ Imrani Comerce “ me seli në Muçivrc ose dëshmitarit përkatësisht kushëririt të Sh. Thaçit edhe atë Sabri Thaçi për ndryshe i dërguar në cilësi të dëshmitarit. Po ashtu nga dokumentacioni i bashkangjitur ekspertizës financiare të ekspertit financiar rezulton se kompania A. D. nuk i ka dërguar me dokumentacion valid rërë apo zhavor as personit me emër A. mbiemri i të cilit nuk është verifikuar nga gjykata, sepse emri i tij përmendet në bisedën telefonike mes të akuzuarit R. dhe dëshmitarit Sh. Th. me përmbajtje si në transkript në vijim të arsyetimit të këtij aktgjykimi.**

-Raportit të Policisë të datës 05.10 2016 si dhe dokumentacionit përcjellës raportet përkitazi me transportimin e rërës nga firma “A. D.“ shpk.

-përgjigja zyrtare e Sektorit të Inteligjencës dhe analizës së rriskut – Dogana e Kosovës me numër të referencës Lj-1-063-5078-081014 të datës se për periudhën kohore 2013-14.09 2014 se subjektet në vijim nuk kanë realizuar asnjë import pranë Doganës së Kosovës për periudhën lëndore : “ Koni Kompani “sh.p.k, “ Xhelal Trans “ sh.p.k. dhe “ Besi Comerc “ sh.p.k.

-licencë e kompanisë “Imrani Company” sh.p.k. me pronar Imran Thaçi lidhur me shfrytëzimin mr nr. 619/icmm/07 i datës 12.11 2009 i lëshuar nga KPMM në Prishtinë për periudhën kohore prej 7 viteve edhe atë 12.11 2007 deri më 11.11 2014,

-licencë e kompanisë “Besi Commerce “ sh.p.k. me pronarë Afrim Spahiu për hulumtime për rërë dhe zhvor për periudhën kohore prej 17.01 2011 deri më 16.01 2013, pastaj licencë për shfrytëzim për rërë dhe zhavor për periudhën kohore nga 06.05 2011 deri më 05.05 2013, licencë për aktivitete të veçanta - për të kryer punët lidhur me seperacionin për periudhën kohore 07.06 2011 deri më 06.06 2014,

-Ekspertiza financiare e ekspertit financiar për periudhën kohore prej janar 2013 e gjer më datën 02 nëntor të vitit 2014 tek kompania “ A. D.” me seli në Ranillug përkatësisht Dheu i Bardhë, lidhur me importimin e rërës dhe zhavorit nga Republika e Sërbisë me kërkesa tjera si në aktvendimin e kësaj gjykate të datës 25 shkurt 2019 të cilës i janë bashkangjitur aktet shkresore të kësaj kompanie së bashku **me faturat përkatëse e cila do të analizohet dhe për përfundimet e nxjerra nga gjykata do të ipet arsyetim përkatës** si dhe

-përgjigja me shkrim e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë lidhur me kërkesat e parashtruara me aktvendim të kësaj gjykate të datë 25 shkurt të vitit 2019, edhe atë për periudhën kohore janr 2013 e gjer në fund të vitit 2014 se për cilat kompani kanë lëshuar licenca, e për kompanit pas marrjes së vendimit të qeverisë së vendit të angazhohen subjektet përkatëse e sidomos sipas Memorandumit të bashkëpunimit sipas fushave të përgjegjësisë se a është hartuar plan i veprimit konform këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi, se për shkalësit e vendimit të Qeverisë çfarë masa janë ndërmarrë sidomos në bashkëpunim me zyrtarin komunal tani të akuzuarin R. L. dhe se a ka evidentuar ndonjë veprim që organi komunal i Komunës së kamenicës me thesk të veçantë të të akuzuarit në fjalë i cili konsiston në tejkalimin e kompetencave të tij ose ndonjë shkelje tjetër zyrtare lidhur me eksploatimin ose transportimin e rërës dhe zhavorit në kuadër të komunës në fjalë të shitur nga kompanitë eksploatuese të zhavorit ose seperimit të rërës në mënyrë ilegale ( ndaj cilave kompani janë ushtruar kallëzime penale nga ky komision).

### 3.Mbrojtja e të akuzuarit

**I akuzuari pas kthimit të lëndës në rigjykim gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë mbrojtjes së tij të dhënë në sencën e shqyrtimit gjyqësor para se lënda me u kthyer në rigjykim edhe atë me përmbajtje si në vijim :**

Në pyetjen e mbrojtësit edhe atë përkitazi me përmbajtjen e transkriptit lidhur me një përgjim me dt.07.07.2014 e posaqërisht me konstatimin në transkript “bile edhe kamioni ka mujt me të shku për ufla”, i akuzuari është përgjigjur: me dt.07.07.2014 sipas përgjimit që është bërë, policia e kanë ndal kamionin me rërë dhe zhavorr dhe na ka ftu policia neve që të dalim në vendin e ngjarjes, po ashtu vlen të konstatohet se policia ka pas urdhëresë nga komandanti i policisë në Kamenicë se çdo kamion që shifet në rrugë absolutikisht duhet të ndalet dhe duhet të konfiskohet, duke u bazuar në vendimin e Ministrisë përkatëse. Ne kemi dal në vend të ngjarjes dhe kemi vërtetuar se dokumentacioni është në gjendje të rregullt, dhe është vërtetuar se i njëjti e ka pas të drejtën e lëvizjes së mëtutjeshme. Atij transportuesi për të cilin bëhet fjalë në dokumentacionin që është kontrolluar, gjithëherë policia e ka bërë një shënim në shpinë të atij dokumenti duke shënuar orën e ndaljes, datën, muajin dhe vitin.

Më tutje mbrojtësi vazhdon me pyetjet e tij edhe atë duke theksuar se në dispozitiv të akuzës thuhet se “...ka ndihmuar në eksploatimin e zhavorrit edhe atë kompanitë : **Imrani comerc, Xhelali Trans, Besi com dhe Krileva com**”. Me theks të veçantë se ju si i akuzuar çfarë raportesh si inspektor keni pas me pronarët e këtyre kompanive, i akuzuari përgjigjet personalisht nuk i kam ndihmuar asnjë kompanie të theksuar nga mbrojtësi im, e siç qëndron në përshkrimin faktik të veprës penale sipas aktakuzës që më vihen në ngarkesë, ndërsa sa i përketë raporteve të mia me pronarët e

këtyre kompanive me përgjegjësi të plotë e them se kemi pas marrëdhënje normale sidomos me ato kompani të cilat kanë qenë të licensuara, pra kanë pas licencë për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit nga KPMM, ndërsa kompanitë të cilat nuk kanë pas këso lloj licencash nuk kemi pas as kontakte e as biseda por edhe marrëdhënje shumë të këqija , e kur e them këtë pjesë të fjalisë së fundit mendoj në atë se nga të njëjtit shumë herë kemi pas kërcënime në drejtim se pse i kem pengu të njëjtit për të transportuar ose ekspluatuar rërë . Për këto thënje të mia kemi edhe dëshmi të kërcënimit dhe se lidhur me këtë lënda gjindet në Gjykatën Themelore –Dega në Kamenicë. Kompanitë të cilat nuk kanë pas licenca dhe nuk kanë pas dokumentacionin në rregullë në bashkëpunim me KPMM kemi konfiskuar rërë dhe zhavor nga transportuesit ilegal. Mendoj se kemi konfiskuar afro 512 m3 dhe i kemi këtë sasi e kemi vendosur tek shtëpia e kulturës në Kamenicë dhe se për këtë mund të ofroj provë të një fotoje dhe këtë mund ta ndërlihi me lëndën e kësaj sasi të shitur nga komuna edhe atë përmes zyrës së prokurimit .

Në pyetjen e mbrojtësit se çfarë raportesh ju keni pas me dëshmitarin Nazif Hajrizin gjatë periudhës sa ka punuar si inspektor komunal në detyrat e lartëcekura, i akuzuari përgjigjet: unë personalisht me komandantin e policisë së SP në Kamenicë kam pasur marrëdhënje të mira zyrtare por edhe njerëzore. Unë bashkarisht edhe me inspektorët e tjerë kemi bashkëpunuar me komandantin e policisë Nazif Hajrizi dhe shumë herë edhe kemi vendos në terren edhe shirita për ndërprejzen e ekspluatimit të rërës për subjektet që nuk kanë pas licenca edhe atë kompanin “Xhelal trans” ,”Coni kompani” dhe “Afërdita” të cilat e kanë selin në fshatin Laçiq.

Unë me komandantin e Stacionit Policor Nazif Hajrizin kemi pasur **edhe mospajtime** lidhur me zbatimin e vendimit të Qeverisë për ato kompani të cilat kanë pasur licenca edhe atë “Imrani comerce” ,”Krileva kompani”, “Besi com”, por edhe kompani tjera. Ndërsa marrëveshja e cila është bërë më 12.04.2012 në mes të KPMM, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Shoqatës “Zhavori” e sipas saj parashihet se ato kompani të cilat kanë licencë nga KPMM **kanë të drejtë ekspluatimi në përputhje me licencat që i kanë**, e mospajtimi im me te ka konsistuar në atë se komandanti i policisë **ka tentuar që mos ta zbatoj këtë marrëveshje dhe çdo herë ka thënë absolutikisht askush s’ka të drejtë të eksplatoj dhe transportoj rërë dhe zhavorr.**

Mbrojtësi i të akuzuarit deklaroi se nuk ka pyetje tjera .

Në pyetjen e prokurorit të shtetit edhe atë se ju si akuzuar keni bërë përshkrimin e detyrave të punës të cilat i keni ushtruar, atëherë a keni dal si **person zyrtar në vend të ngjarjes edhe atë në fsh.Laçiq , lumi Krivareka etj pa polici** , i akuzuari përgjigjet: po, ne kemi dal në vend të ngjarjes në fshatin Laçiq pa polici për të kontrolluar kompanit që kanë ushtruar veprimtarin e rërës dhe zhavorrit edhe atë kompania “Xhelal trans”, “Coni kompani” dhe kompania “Afërdita” .Kemi dal edhe herave tjera dhe tek këto kompani kemi hasur duke ekspluatuar rërë dhe zhavorr përtej shtratit të lumit të Desivojcës, gjersia e këtij lumi është afërsisht afro 18 metra , ndërsa thellësia prej 30-40 cm por kjo varet nga sezona –të reshurave. Ne në momentin që i kemi pa këto kompani duke ekspluatuar rërë përtej këtij lumi, kështu që në momentin që na kanë vërejtur i kanë fikur makinat dhe vozitësit e makinave kanë ik në mal, mirëpo pamvarisht atyreve ne kemi bërë fotografimin e atij vendi ku kanë ekspluatuar rërë pasi që nuk kemi mundur që të dalim në anën ku është ekspluatuar rëra për shkak të lumit të lartëcekur dhe për këto veprime të tyre ne kemi bërë edhe fletëparaqitje në Gjykatën Komunale në Kamenicë. Në Gjykatën Komunale në Kamenicë psh. po e përmendi një rast që kemi paraqitë një fletëparaqitje me dt.10.04.2014 ndaj kompanisë “Xhelal Trans” pasi që e njëjta ka ekspluatuar rërë dhe zhavor në tokë bujqësore dhe nuk e ka bërë ndërrimin e destinimit edhe atë nga toka bujqësore në tokë të përshtatshme për ekspluatim sipas ligjit të tokave bujqësore. Në të njëjtën kohë me të gjitha të dhënat që i kemi marrë në terren kemi njoftuar KPMM lidhur me operimet ilegale që zhvillohen nga disa kompani e siç i ceka edhe më herët, ka edhe raste të tjera por po e përmendi edhe një rast të fundit kur kompania Xhelal trans pronar i të cilës është Xhelal Kryeziu ku i njëjti me makineri kishte filluar ekspluatimin në hyrje të fshatit Desivojcë mirëpo në bazë të informatës që kemi marrë nga qytetarët të atij vendi unë së bashku me kolegët e mi inspektor duke bashkangjitur edhe disa polic kemi shkuar në vend të ngjarjes dhe kemi pa se pronari i subjektit në fjalë ka filluar të eksplatoj rërë dhe zhavorr edhe atë në tokën bujqësore, kemi bërë një



procesverbal, kemi ndërprerë eksploatin nga kjo kompani dhe kemi urdhëruar të njëjtën para neve ta mbyll vendin ku rëra është eksploatuar . Kemi edhe raste të tjera kur kemi ftuar policin edhe atë për hir të sigurisë sonë si persona zyrtar dhe bashkarisht me të njëjtit në kuadër të kompetencave tona kemi marrë veprime zyrtare konkrete. Po ashtu mund të them edhe këtë se neve na janë bashkangjitë edhe zyrtarët për emergjencë dhe në të gjitha ato vende ku është eksploatu rërë dhe zhavorr kemi vendos shiritat për ndalimin e eksploatimit.

Gjatë vitit 2013 ka ushtruar detyrën e inspektorit komunal për resurse natyrore, ndërsa gjatë vitit 2014 ka ushtruar detyrën e përgjegjës të inspektoratit komunal për të gjitha lëmit.

I akuzuari e ka mohuar kryerjen e veprës penale duke u arsyetuar se as nuk i ka keqpërdorur e as nuk i ka tejkaluar kompetencat e tij. Në komunën e Kamenicës ka filluar me punë si inspektor i resurseve natyrore prej muajit prill 2000, ndërsa si përgjegjës i Inspektoratit Komunal të Komunës së Kamenicës është emëruar më datën 25 prill 2014, e sektori i Inspektoratit gjendet në kuadër të Drejtorisë Komunale për shërbime publike, ambient dhe inspektorat, pra në vitin 2013 kam ushtruar detyrën e Inspektorit të resurseve natyrore. **Detyrat e Inspektorit komunal të resurseve natyrore kanë qenë : me zbatuar rregulloret që kanë të bëjnë me eksploatin e resurseve natyrore dhe se që nga vitit 2010 kur ka hy ligji për minierat dhe mineralet kompetencat e inspektorit komunal të resurseve natyrore kanë kaluar në kompetencë të Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale me qendër në Prishtinë.** Unë kam qenë i njoftuar verbalisht nga ish drejtori i Inspektoratit lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 02.11 2011 **mbi ndalimin e eksploatimit të materieve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat e lumenjve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.** Urdhurat e ish drejtorit të gjithë inspektorët i kem respektuar pra duke më përfshirë edhe mua sa i përket zbatimit të vendimit të Qeverisë e që kanë konsistuar në ndaljen e eksploatimit të rërës dhe zhavorrit në Komunën e Kamenicës, e të cilët nuk kanë pas licenca. Në një pikëpamje ne jemi urdhëruar që të dalim edhe në rrugë për ta zbatuar këtë vendim të Qeverisë. Pra ne kemi vepruar sipas urdhrat të kryetarit të komunës dhe ish drejtorit të inspektoratit, edhe atë gjatë periudhës kohore 2011-2014 duke konfiskuar sasi të rërës dhe zhavorit nga eksploatuesit të cilët nuk kanë pas licenca edhe atë një sasi prej 512 m3 dhe pas shtëpisë së kulturës të njëjtën e kemi deponuar dhe si aset i komunës së Kamenicës është shit në ankand publik gjatë vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe kemi hap edhe procedura gjyqësore ndaj eksploatuesve të cilët nuk kanë plotësuar kushtet ligjore por nuk kemi pasur kompetencë të shqiptimit për gjoba për arsytet që i thashë më herët.

**Sipas një memorandumi me numër 1396 të datës 05.04 2012 e cila ka qenë marrëveshje bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror, Komisionit për Miniera dhe Minerale, OJQ “ Zhavori “ me sa e dij me seli në Prishtinë me të cilën është lejuar që ata që kanë licenca për eksploatin e rërës dhe zhavorit të vazhdojnë aktivitetin konform licencave që i kanë edhe atë në sipërfaqet e definuara me licencë. Në kuadër të Komunës së Kamenicës kanë pas licenca këto kompani : SHPK Imrani Comerc me seli në Muqiverc për periudhën kohore 21.01 2007 – 11.11 2014, SHPK Besi Comerc me seli në Muqivrc për periudhën kohore 07.06 2011 deri më 06.06 2014 dhe njërit aplikues për vazhdimin e licencës pasi që ky subjekt ka pas të lejuar edhe shitjen e stoqeve të rërës dhe zhavorit që i ka pas në separacion, Krileva Compani me seli në Kamenicë për periudhën kohore 25.01 2008 deri më 25.01 2015, Kompania “ A. D.me seli te Dheu i Bardhë e që i takon Komunës së Ranillugut , SHPK “Xhelali Trans” me seli në Laçiq përkatësisht Desivojc e cila ka pasur licencë për periudhën kohore deri më 24.12 2014 e veprimtari e saj ka qenë eksploati i rërës dhe zhavorit, pastaj SHPK “Adi Comerc “ me seli në Hodonovc me licencë duke filluar prej 14.03 2013, SHPK “Xhelali Trans” me seli në Laçiq ka marrë licencë për aktivitete të veçanta në lëmin e eksploatimit të rërës dhe zhavorit më datën 06.09 2012 edhe atë për dy vite.**

Asnjërin prej kompanive nuk i kam udhëzuar dhe këshilluar për të siguruar dokumente fiktive për të ushtruar veprimtarinë e tyre rreth eksploatimit të rërës dhe zhavorit në kuadër të Komunës së Kamenicës.

Në pyetjen se cili ka qenë qëllimi i komunikimit të juaj siç e dëgjua në riprodhimin e CD-s me pronarët apo përfaqësuesit e këtyre kompanive, i akuzuari është përgjigjur, se qëllimi ka qenë se secili që ka vepruar në kuadër të Komunës së Kamenicës për eksploatimin e rërës dhe zhavorit, të veproj në kuadër të ligjit dhe se nga të njëjtit nuk ka pasur kurrfarë interesi, pasi që ka pasur obligim ligjor që çdo palë e cila i është drejtuar përmes telefonit rreth çështjes së eksploatimit të rërës dhe zhavorit t'i jap ndonjë udhëzim për ushtrimin e ligjshëm të veprimtarisë së tyre. I akuzuari i ka identifikuar personat e kompanive me të cilët ka komunikuar me telefon siç qëndron në CD-në e riprodhuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i akuzuari është përgjigjur se përmes ish drejtorit Muhamet Thaçi jam njoftuar për njoftimin me shkrim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me numër 01 2662/11 të datës 05.12.2011 lidhur me pezullimin e të gjitha pëlqimeve mjedisore për operatorët e rërës dhe zhavorit të cilët janë të pajisur me pëlqime mjedisore nga MPP- në pajtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/2011 të datës 02 nëntor 2011, për shkak të ndalimit të eksploatimit të rërës dhe zhavorit kompanive që nuk kanë pasur licenca. Prokurori i shtetit ka sqaruar se sipas nenit 3 të Marrëveshjes së bashkëpunimit të theksuar më lart parashihet shfrytëzimi i materialeve inerte jashtë shtretërve të lumenjve nga subjektet e licencuara.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit se ju keni thënë se SHPK "A. D." ka vepruar në kuadër të Komunës së Ranillugut, atëherë cila ishte arsyeja e komunikimit me R. V.n, i akuzuari është përgjigjur se ka biseduar me R. V.n dhe nga ai ka kërkuar sasinë prej 200 metra kub rërë dhe zhavorr dhe se kjo bisedë ka rrjedh nga personi Sabri Thaçi nga Muqivërci i cili me qëllim të ngritjes së një ferme për lopë qumështore ka bërë kërkesë në Inspektorat për marrjen e pëlqimit ose leje mjedisore komunale, e me të cilin është takuar në Roganë rastësisht dhe më ka pyetur për sigurimin e dokumentacionit për 200 metra kub me dokumentacion valid meqë ka nevojë për kompletimin e dokumentacionit për subvencion për ngritjen e shtallës së tillë në Ministri të Bujqësisë. Sabriun e ka njoftuar me telefon se ka biseduar me pronarin e kompanisë "AGI DAN" R. V. dhe se ka marrë përgjigje se nuk mund me siguruar më shumë se 18 metra kub, e sasia prej 200 metra kub ka qenë kusht të aplikimit për subvencion.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit me rastin e ballafaqimit të të akuzuarit me përmbajtjen e transkriptit të datës 07.07.2017 duke ia lexuar përmbajtjen e këtij transkripti, se kush është personi me të cilin keni biseduar, i akuzuari është përgjigjur : në bazë të numrit të telefonit 044 244 105 është Sh. Thaçi kurse **A.i** e ka mbiemrin Thaçi dhe ai është pronar i një kafiterie në fshatin Muqivërc. Ky i fundit nuk është marrë me shitblerjen e rërës dhe zhavorit, duke shtuar se kjo përmbajtje nuk ka të bëjë me kurrfarë ndërmjetësimi të A.it për të importuar zhavor dhe rërë por as për të bartë prej një vendi në vendin tjetër, thënë të vërtetën kjo ka qenë vetëm shaka e karakterit privat. Sa i përket personit me emrin A. nuk njeh ndonjë person i cili me këtë emër merret me rërë dhe zhavor.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i akuzuari është përgjigjur se ka vepruar drejt kur ka komunikuar me eksploatuesit e rërës pasi që mendon se nuk ka konflikt interesi.

Në pyetjen e anëtarit të trupit gjykues i akuzuari është përgjigjur se është dashur patjetër të zbatohet vendimi i Qeverisë por edhe marrëveshja – memorandumit i lidhur mes subjekteve përkatëse. Urdhëratë e eprorëve qofshin me shkrim ose me gojë mendon se ka obligim për t'i respektuar.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i akuzuari është përgjigjur: po, kemi dal në vend të ngjarjes në fshatin Laçiq pa polici për të kontrolluar kompanit që kanë ushtruar veprimtarin e rërës dhe zhavorrit edhe atë kompania "Xhelal trans", "Coni kompani" dhe kompania "Afërdita". Janë dal edhe herave tjera dhe tek këto kompani i kanë hasur duke eksploatuar rërë dhe zhavorr përtej shtratit të lumit të Desivojcës , gjersia e të cilit lum është afërsisht afro 18 metra , ndërsa thellësia prej 30-40 cm por kjo varet nga sezona –të reshurave. Në momentin që kanë parë këto kompani duke eksploatuar rërë përtej këtij lumi, personat e kanë fikur makinerinë duke ikur në mal, mirëpo pamvarisht kësaj është bërë fotografimin i atij vendi ku kanë qenë duke eksploatuar rërë pasi që nuk kanë mundur që të dalin në anën ku është eksploatuar rëra për shkak të lumit të lartëcekur dhe për këto veprime të tyre janë bërë edhe fletëparaqitje në Gjykatën Komunale në Kamenicë. Në Gjykatën Komunale në Kamenicë psh. ka përmendur një rast që e kam paraqitur duke ushtruar një fletëparaqitje me dt.10.04.2014 ndaj kompanisë "Xhelal Trans" pasi që e njëjta ka eksploatua rërë dhe zhavor në tokë

bujqësore dhe nuk e ka bërë ndërrimin e destinimit edhe atë nga toka bujqësore në tokë të përshtatshme për eksploatim sipas ligjit të tokave bujqësore.

Në të njejtën kohë me të gjitha të dhënat që i kanë marrë në terren e kanë njoftuar KPMM lidhur me operimet ilegale që zhvillohen nga disa kompani e siç u theksua edhe më herët, ka edhe raste të tjera ku kanë ndërprerë eksploatimin nga këto kompani dhe kanë urdhëruar posaçrisht nga kompania në fjalë mbylljen e vendit ku rëra është eksploatuar.

I akuzuari po ashtu është mbrojtur se të gjitha pëlqimet për operatorët e rërës dhe zhavorit nuk janë ndalu sipas vendimit të Qeverisë, sepse për rastet e marrjes së licencave nga këto kompani operatorët kanë vazhduar eksploatimin e rërës jashtë brigjeve të lumit në një distancë prej 150 m. nga lumi.

#### 4.Provat personale

**Deklarata e dëshmitarit Nazif Hajrizi – komandant i Stacionit Policor në Kamenicë që nga viti 2012,** ka deklaruar se R. L. e njeh dhe e din se punon në Inspektorat komunal të Komunës së Kamenicës. Ka njohuri për eksploatimin e rërës gjatë periudhës 2013-2014, duke dhënë shpjegime rreth detyrave me të cilat ka qenë i ngarkuar për të grumbulluar informata për zhvillimet lidhur me eksploatimin e rërës dhe zhavorit për ta njoftuar Policinë e Kosovës – njësitin kompetent të saj. Më tutje deklaroi se e kemi poseduar Vendimin e Qeverisë për ndalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorit dhe se kemi pasur për detyrë që ta zbatojmë këtë vendim në praktikë, e duke pasur parasysh edhe ankesat e drejtuara nga ana e komunitetit të zonës ku është zhvilluar ky aktivitet rreth eksploatimit të materialeve në fjalë, Për të menaxhuar më lehtë kam kërkuar bashkëpunim me institucionet tjera të cilat në bazë të ligjit dhe vendimit të Qeverisë kanë qenë të obliguar që të marrin veprime konkrete për ndërprerjen e kësaj dukurie rreth eksploatimit në fjalë. Kam kërkuar bashkëpunim me Inspektoratin Komunal në Kamenicë por edhe me Inspektorët e pavarur për miniera dhe minerale me seli në Prishtinë duke përfshirë edhe prokurorinë e shtetit. Në disa takime zyrtare me inspektorët komunal ku ka qenë edhe R. L. por edhe me Inspektorët e komisionit të pavarur, jemi dakorduar që të ndërmarrim veprime konkrete konformë ligjit dhe vendimit në fjalë. Thënë të vërtetën në këtë proces e sipër kemi hasur në pengesa në terren pasi që zyrtarët policor shpesh herë i kanë ndaluar kamionët që kanë transportuar zhavor, të cilët në të shumtën e rasteve kanë ofruar disa dokumente si p.sh. një paragon bllok nga kompania ku është ngarkuar zhavori dhe në disa raste kanë ofruar disa dokumente doganore të quajtura DUD gjoja se zhavorin e kanë importuar nga Serbia dhe se e kanë dërguar në fshatin Laçiq për me seperue e pastaj me e lëshuar në treg. Për mua si komandant dhe policinë vërtetë ka qenë absurd sipas meje këtë absurditet mund ta shpjegoj me atë se nuk është e mundur se në aspektin ekonomik që zhavori të importohet nga Serbia kurse të seperohet në Laçiq për t'u lëshuar në treg. Çdo herë kam kontaktuar Inspektorët Komunal të Kamenicës por edhe të Komisionit të Pavarur për miniera dhe minerale dhe shpesh herë edhe policia ka ndejtur me intervale kohore prej 6 orëve e ndoshta edhe më shumë në vendin ku i kanë ndaluar kamionët që kanë transportuar zhavor, unë si komandant jam informuar se kanë pasur divergjencë rreth kompetencave për të ndërmerr veprime konkrete në këtë situatë edhe atë në mes Inspektoratit Komunal të Kamenicës si dhe të Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale. Si komandant unë jam informuar nga policët se në disa raste zhavori është seperue dhe zbratur në depon komonale në Kamenicë e në disa raste edhe është liruar pikërisht duke u bazuar në dokumentet doganore – DUD, duke u liruar disa prej tyre pikërisht me sugjerime të Inspektorëve komunal të Kamenicës. Për kamionët e liruara nga policët kam kërkuar që të përpilojnë shënim zyrtar dhe prej inspektorëve komunal të kërkojnë procesverbalin mbi lirimin apo mbi veprimin që ata e kanë ndërmarr lidhur me kamionët e ndaluar që kanë transportuar zhavor, dhe se në këto procesverbale e di se janë shënuar edhe emrat e inspektorëve që i kanë ndërmarr veprimet konkrete në fjalë dhe unë si komandant i Stacionit Policor qëndroj prapa raporteve të policëve që i kanë përpiluar për rastet në fjalë. Pasi ë kam vërejt se procesi rreth ndalimit të eksploatimit të zhavorit nuk po rrjedh si duhet kam përpiluar një Raport me shkrim duke ju drejtuar Drejtorit Rajonal të Policisë në Gjilan me kërkesë që Njësia për krime ekonomike që të filloj hetime lidhur me këto dyshime të prezentuara në raport.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit – dëshmitari është përgjigjur se si komandant i policisë kam vizituar vendet ku është eksploatuar zhavori në kuadër të territorit të Komunës së Kamenicës dhe si person zyrtar por jo profesional për lëmin përkatëse konsideroj se gjendja vërtetë është katastrofale.

**Dëshmitari R. V.** është dëgjuar dy herë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor si pronar i kompanisë “ A. D.” me seli në Gjilan rruga “ R. Mala “ nr. 34, i cili ka separacon edhe në Ranillug – te Dheu i Bardhë, dhe se i njëjti posedon SIM kartelën me nr.044 575736, dhe se ka deklaruar se ka qenë i njoftuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorit.

Ky dëshmitar është dëgjuar më datën 13 prill 2016, ku ka mohuar se ka raporte miqësore apo shoqërore me R. L.n dhe se pas leximit të transkriptit të bisedës telefonike të numrit të lartcekur dhe numrit 044 231000 lidhur me bisedën mes R. L.t dhe të këtij dëshmitari, dëshmitari ka deklaruar se R. u për Sh. Th. ka kërkuar 200 kubik zall por dëshmitari i ka premtuar vetëm 20 kubik sepse nuk ka mundur me i siguruar më shumë prej Serbisë dhe se e kanë lanë me u takuar në Rogoçicë **tek kafiteria e Velisë. Dëshmitari ka shtuar edhe këtë se shoferat e mi me kamion transportues ia kanë dërguar 20 kubik zall te shtalla në fshatin Muçivrc por zall i ka dërguar edhe herave tjera.**

Në pyetjen se prokurorit ky dëshmitar është përgjigjur se unë kam siguruar zall me letra prej Serbisë dhe **nuk mund të sqarohem se pse R. u ka kërkuar dokumentacion për zall për Sh. Th..** Ka deklaruar edhe këtë se unë kam siguruar zall me dokumentacion valid nga Serbia, dhe mban evidencë të rregullt për dokumentacionin rreth furnizimit me zhavor nga Serbia.

Në deklaratën e këtij dëshmitari – **R. V.** të dhënë në seancë më datën 11 nëntor 2016 – pas pyetjes së parashtruar nga prokurori i shtetit – se me vet faktin se deklarata e juaj e dhënë në Polici dhe gjatë shqyrtimit të kaluar gjyqësor lidhur me këtë çështje penale por edhe **nga raporti shtesë i hetuesit të Policës së Kosovës është kontradiktore, a keni biseduar me R. un për sigurimin e 200 kub zall me dokumentacion përcjellës për Sh. Th., dëshmitari R. V. ka deklaruar se kemi biseduar por unë jam marr vesh për 20 kubik e jo për 200 kubik .**

Në pyetjen tjetër se a i keni dërguar zall Sh. Thaçit sipas kërkesës së R. Latifit dëshmitari është përgjigjur jo pra as zall e as dokumentacion përcjellës dhe se nuk e din se për çka R. u ka kërkuar rërë dhe dokumentacion prej meje për Sh. Th..

Me lejen e gjykatës prokurori i shtetit ka lexuar transkriptin e datës 01.07 2014 me fillim në ora 12,35 minuta edhe atë si në vijim “ **R. u e thirr në telefon njëfarë R.in që tani për tani për ne është i panjohur dhe nga i njëjti kërkon që t’ia rregullon disa dokumente doganore për disa kubik zall. R. u kërkon dokumentacion për një person të tretë edhe atë 200 kubik zall po ai ( mendohet në R.in ) premtom njëherë për 20 kubik zall dhe e lënë të takohen në Rogoçicë tek Kafiteria e Velisë”.** Më tutje prokurori i shtetit këtë përmbajtje të lexuar deklaroi se mund ta mbështes edhe në riprodhimin e përmbajtjes së këtyre fjalëve në CD-n ku edhe dëgjohet zëri i bisedave telefonike në mes të R. L.t dhe R. V.t, pasi që njëkohësisht në seancën e kaluar ka propozuar që CD-ja e bisedave telefonike në mes të të akuzuarit R. L.t dhe R. V.t si dhe dëshmitarëve tjerë eksploatues të rërës të administrohet si provë.

Me leje të gjykatës prokurori i shtetit këtë dëshmitar e ka ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë në prokurori më datën 05.11 2014 edhe atë në faqen 3 pasuesi i 5 edhe atë “**meqenëse R. un e njihni vetëm si person zyrtar përkatësisht inspektor në Kamenicë, për çfarë arsye është bërë kjo bisedë e datës 01.07 2014 me përmbajtjen siç u theksua në deklaratën e dhënë në prokurori më datën e lartcekur, dëshmitari R. është përgjigjur : nuk mund të sqarohem për këtë por unë kam kuptuar ashtu siç ceka më lart, ndoshta i ka lyp për 200 kubik zall por unë e kam kuptuar për 20 kubik zall dhe se R. un e njoh si inspektor në Kamenicë, nuk kemi raporte të afërta me te.** Në pyetjen intervenuese të kryetarit të trupit gjykues dëshmitari R. V. është përgjigjur : “ e vërtetë është ajo që po them tani se vërtetë nuk e kam ditur se R. L. ka qenë zyrtar apo inspektor i Kamenicës.

Në pyetjen sqaruese të prokurorit të shtetit, dëshmitari R. është përgjigjur se unë gjatë vitit 2010 nuk e kam ditur se R. u është inspektor.

**Dëshmitari Ramiz Spahiu** për ndryshe vëlla i pronarit **Afrim Spahiu** në firmën “**Besi Com**” me seli në Muçivrcë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurori më datën 05.11 2014, duke sqaruar se sipas porosisë personave të interesuar ju kemi qar zall me dokumentacion të rregullt, e me sa e dinë i njëjti vëllai i tij Afrimi **nuk ka importuar zall nga vendet fqinje të Kosovës.** Se pasi që e kanë ndal policia me kamion dhe ka prit dy orë, e ka ftuar inspektorin R. i cili ka ardhur në vend të ngjarjes dhe pasi që ka konstatues se ka dokumentacion të rregullt e ka liruar me shkuar me kamionin e ngarkuar me zall. Ka dëgjuar përmes televizionit se Qeveria e ka prur një vendim për ndalimin e eksplotimit të zallit.

Në deklaratën e këtij dëshmitari të dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjilan më 05.11 2014 i njëjti pas ballafaqimit me përmbajtjet e transkripteve ka pranuar se ka pasur biseda telefonike me R. L.n, por ka sqaruar se kinse është liruar nga R. u kur ka ardhur në vend të ngjarjes sepse e ka pasur dokumentacionin në rregull.

Në përmbajtjen e traskriptit të nxjerrur nga bisedat telefonike më datën 07.07 2014 i akuzuari R. ka thënë “ ... po e di u kry i thotë se policia e kishin thirr R. un dhe se u kry kjo **punë u morra vesh me ta i njëjti tregon se letrat i ka marr nga A.i që e ka prur zallin nga Serbia**, unë nuk e di “ kurse ky dëshmitar është përgjigjur po është e vërtetë kjo bisedë dhe pasi që kanë verifikuar dokumentet edhe pse ma patën ndal kamionin me rërë pasi që R. u ju ka thënë se gjithçka është në rregull me që i kanë marrë faturat kopje dhe më kanë liruar.

**Dëshmitari Afrim Spahiu** – ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurori më datën 05.10 2014 edhe atë pa ndryshime dhe plotësime. Në këtë deklaratë ka theksuar se ka licencë për hulumtimin e rërës dhe zhavorit, për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorit dhe për seperimin e rërës dhe zhavorit nga organi kompetent, se është i njoftuar me vendimin e Qeverisë për ndalimin e eksplotimit të rërës dhe zhavorit, por që ky atë e bënë 200 m. larg lumit “**Morava** “ nga një arë e cila është pronë e tij që e ka blerë. Nuk importon rërë nga Serbia sepse atë e bënë -eksploton nga prona e tij.

**Dëshmitari Sh. Thaçi** – ka deklaruar në tërësi si në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori dhe se kompania “**Imrani** me seli në Muçivrc është pronë e vëllait të tij Imran Thaçi por aty edhe ky punon, se ka qenë në dijeni për vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin e eksplotimit të rërës dhe zhavorit, por kjo kompani ka qenë e pajisur me dokumentacion valid. Posedon numrin e telefonit 044 244 105 por e din edhe numrin e R. L.t e që është regjistruar 044 231-000.

Prokurori i shtetit këtë dëshmitar e ka ballafaquar **me transkriptin e bisedës telefonike më datën 02.07 2014 edhe atë me numrat e telefonit si më lart edhe atë rreth orës 14:20** me përmbajtje si në vijim : “ **o shef a je bre** “ i njëjti ia ka kthen duke i thënë “ **fol** “ dhe fillimisht pasi që e përshëndesin njëri tjetrin, personi N.N. e që është dëshmitari në fjalë ( Sh. Thaçi “ **thotë duke i treguar se “ kjo e kshyra unë ish deri në muajin 11 të vitit 2014**, deri në dimër, Inspektori ( R. L. ) i thotë “ **boja një kopje qati dosti duke i thënë ngomë mua çka pot thom dhe i tregon duke i thënë le ti thotë se ajo ka vlej për ata që skan fare licenca, njëherit i thotë mos i trego që të kam que unë ( vërejtje : R. L. ) edhe e sugjeron duke i thënë qato letrat boni patjetër, pala i thotë po po veç të nesërmën në mëngjes se sot nuk mundem, pastaj inspektori ( vërejtje : R. u ) i thotë : “qato letra me sabah i bon me vete dhe u bitis, njëherit i thotë se kur të vijnë ata mos u dorëzo i thu që unë i kom pi doganës pra kur të vijnë ata ja qet letrat edhe i thu qe i ke prej doganës për neve, në fund i thotë shtërngov njëherë tani “.** Në pyetjen e prokurorit lidhur me sqarimin e këtij traskripti – dëshmitari është përgjigjur unë kam kërkuar zhavor me dokumente sepse ai ka bajt prej Serbisë zhavor edhe atë nga R. V. pronar i firmës “**A. D.**“me seli te Dheu i Bardhë, sqarime tjera nuk kam”. Nuk i kujtohet se a ka bënë biseda tjera me R. L.n.

**Pastaj, prokurori i shtetit e njofton këtë dëshmitar me përmbajtjen e një raportit policor të datës 08.07 2014 rreth ndaljes së automjetit transportues MAN me targa 629 KS 127 i ngarkuar me 15 metra kub zhavor, dhe se policia e ka njoftuar Inspektorin R. L. i cili ka qenë në vend të ngjarjes, dëshmitari Sh. Thaçi përgjigjet : se zalli nuk është marr sepse unë kam poseduar dokument edhe**

atë kam pas licencë dhe se ajo sasi është marr te kompania A. D.në Crep ( vërejtje : Dheu i Bardhë ) dhe se kjo rërë ka qenë duke u dërguar te ferma në Muçivërc tek kushëriri im Sabri Thaçi me sa e di ai me dokumentacion të rregullt e ka siguruar një sasi të caktuar edhe atë me dokumentacion të rregullt doganor. Më tutje deklaron se kamioni me zhavor është liruar nga ana e policisë dhe inspektorit R. L. pasi që unë kam pas në posedim dokumentacionin e rregullt.

Këtë dëshmitar e kaa ballafaquar prokurori i shtetit me transkriptet e bisedës telefonike më datën 07.07 2014 në ora 21:17 minuta përmes telefonave 044 231-000 ( vërejtje telefon i R. ut ) dhe 044 244-105 ( telefon i dëshmitarit në fjalë ) me përmbajtje si në vijim: “ku je shef “ dhe pasi që përshëndeten mes veti Inspektori ( R. u ) e pyet se ku gjendej, i njëjti ( dëshmitari në fjalë ) ia kthen se dola te A.i dhe jam tu pi ni kafe, më pas i akuzuari R. e pyet “se çka po thotë ai burr”, ky ( dëshmitari në fjalë ) e njofton “se kurgjë duke qeshur, më pas inspektori tani i akuzuari R. i thotë se “ ke tu i shku kamioni nashta po zalli, ke tu i shku për ufla, bile edhe kamioni ka mujt me i shku, më pas fillon duke qeshur me të madhe, më pas inspektori e pyet këtë person, se çka bone ti a mujte me kry punë diçka, naj diçka si for, i njëjti ia kthen duke i thënë : mos po ta kryen naj njo duke i rezervuar, më pas inspektori i thotë: valla ai pshtoj për pak qaj shoqi qaty, më pas ky personi i thotë : është burr i mirë, ndërsa inspektori i thotë : valla po po mu dasht me qu atje njo të mirë dhe kryti punë deri të ngojnë”.

Në pyetjen se kush është A.i, dëshmitari përgjigjet : këtë bisedë vërtetë unë e kam biseduar me R. un, por kjo ka qenë hajgare tu nejt tu pi kafe.

Më tutje prokurori e ballafaqon dëshmitarin me përmbajtjen e transkriptit lidhur me bisedat telefonike të bëra mes të akuzuarit R. dhe këtij dëshmitari më datën 03.07 2014 rreth orës 12:41 minuta “ ...inspektori R. e pyet dëshmitarin në fjalë se “a kishte kryer diçka punë rreth një muhabeti apo letra të doganës që kishin biseduar më herët, ... më pas inspektori i thotë : “shiqo ti nëse mundesh e merr diçka Bujanovc- Muçivërc apo i thotë ti blej një herë një kamion zall sa për mi siguruar do letra, tani e shfrytëzon të njëjtin dokumentacion, inspektori e sugjeron duke i thanë se nuk ka lidhje ta kesh njëherë dhe i thu se e kam blerë prej atij edhe tana shnosh, merre një herë edhe pak punë duke i thënë se ska lidhje personi NN ( vërejtje : dëshmiari në fjalë ) i thotë aha okej flm u kry pra .

Në pyetjen e prokurorit të shtetit dëshmitari deklaron se përmbajtja e transkriptit është e vërtetë dhe se ky ka qenë i obliguar që të siguroj zhavor për djalin e axhës – Sabri Th., të cilin e ka furnizuar me zhavor për ngritjen e fermës në fshatin Muçivërc, dhe se sigurimi i dokumentacionit valid ka qenë i nevojshëm sepse ngritja e fermës së kushëririt tim ka qenë donacion dhe se ka qenë më se e detyrueshme të faktohet me dokumentacion përkatës. Nga eksploatimi i zhavorit duke u nisur nga ajo që kem zhvilluar biseda me R. un as nga unë e as nga vëllau im nuk ka përfituar kurrëfarë dobie pasurore.

Gjykata përmes dy ekraneve kompjuterike gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka riprodhuar CD e nxjerr në procedurë ligjore dhe se në përmbajtjen e saj asnjëra prej palëve nuk ka pasur kurrëfarë vërejtje. Vlen të theksohet se ajo që është dëgjuar por nuk është parë me sy, në tërësi është në transkriptet e bisedave telefonike mes të akuzuarit R. dhe eksloatuesve të rërës dhe zhavorit në Komunën e Kamenicës, e një pjesë e tyre është paraqitur më lart në këtë arsyetim, përmbajtja e të cilave transkripteve në vijim vetëm se do të vlerësohet nga trupi gjykues veç e veç dhe në lidhje me provat tjera të administruara lidhur me këtë çështje penale

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor janë lexuar transkriptet mes akterëve që kanë zhvilluar biseda telefonike – edhe atë i akuzuari R. me ekspluatuesit e rërës dhe zhavorit, por edhe me të gjithë dëshmitarët e dëgjuar gjatë seancave gjyqësore lidhur me këtë çështje penale në përjashtim të dëshmitarit Sabri Thaçi. Përmbajtja e këtyre transkripteve është në përputhshmëri të plotë me përmbajtjen e CD-s së riprodhuar gjatë seancës gjyqësore, në të cilën palët nuk kanë pasur kurrëfarë vërejtje, por edhe dëshmitarët përmbajtjen e tyre nuk e kanë kundërshtuar por kanë dhënë sqarimet e tyre, përmbajtja e të cilave transkripte do të vlerësohet nga trupi gjykues në lidhje me provat tjera të administruara.

**Dëshmitari Sabri Thaçi** Ky dëshmitar është me vendbanim në fshatin Muqivërc, Komuna e Kamenicës dhe se i njëjti merret me bujqësi përkatësisht ka të hapur një fermë të lopëve e cila gjendet në fsh.Muqivërc edhe atë 20 krerë të lopëve qumshtore dhe se këtë **fermë e ka ndërtuar gjatë vitit 2014 dhe se grand e ka pas prej Ministrisë së Bujqësisë së vendit**, duke lidhur **kontratë për fillimin e punimeve me Ministrinë e Bujqësisë me dt. 30 qershor 2014, me detyrim që brenda 90 ditëve ta përfundoj shtallën e lopëve qumshtore**. Mirëpo, meqë nuk ka arritur që ta përfundoj ka kërkuar afat shtesë dy apo tri javë dhe Ministria ia ka aprovuar. Shtalla ka përmasat 23x12 metra por ka pas edhe një gropë skeptike edhe atë me përmasa 8x6 dhe thellësi 2 metra duke përfshirë edhe një angare me dimensione 20 x10 m.

Ndërtimin e ka bërë me mjeshtër privat, ndërsa materialin për ndërtimin e shtallës e ka marrë nëpër depo-shitëse dhe **se ka pas obligim që Ministrisë me i ofru dëshmi për çdo material që është futur në objekt**.

Beton ka marrë prej NTP “Sistemi” në Gjilan, rërën e kam marrë por vetëm një kamion me 10 deri 15 kubik prej kompanisë “Agi Dani” me pronar Rexhen, kurse sasinë tjetër e ka marrë tek firma “Cofix” me seli në Koretisht .

Kjo shtallë i ka kushtuar mbi 50 mijë euro, ndërsa sipas kontratës Ministria këtë shumë ia ka mbuluar 70 % edhe ate afro 28 mijë euro. Sa i përket sigurimit të materialit për këtë shtallë personalisht ka qenë i angazhuar dhe se për çdo material që e kam harxhuar për ndërtimin e kësaj shtalle është dashur që me dokumentacion valid të mbulohet pasi që sipas kontratës kam pas detyrim që dokumentacionin e tillë t’ia dorëzoj Ministrisë së Bujqësisë në mënyrë që e njëjta të bëjë pagesën sipas kontratës.

Me “Agi Danin” personalisht nuk e ka kontraktuar rërën në sasi prej 10-15 kubik por këtë e ka bërë **Sh. Thaçi i cili edhe e ka bërë transportimin**, ndërsa dëshmitari e ka bërë pagesën. Sh. Thaqin e kam kushëri. Për transport Sh. Thaçit me sa i kujtohet ia ka paguar 80 Euro ndërsa 120 Euro në emër të çmimit për blerjen e zhavorrit. **Sh. Thaçi për këtë sasi të sjellur të rërës i ka thënë se më vonë do t’ia sjell dokumentacionin, por këtij dëshmitari nuk i kujtohet se ia ka sjell apo jo**.

Sh. Thaçi gjatë vitit 2014 e di se ka **pas një seperacion të rërës dhe zhavorrit edhe ate në fshatin Muqivërc . Me R. L.n ka biseduar ky dëshmitar përkatësisht se të njëjtin e ka pyetur meqë ka qenë i interesuar që me dokumentacion t’ia siguroj 200 kubik zall**. Unë e pyta R. un sepse mu ka dasht zalli me dokumentacion. **R. un e kam takuar në fshatin Rogoqicë edhe ate në një restoran në Rogoqicë edhe atë në një restoran afër objektit të KEDS-it .R. u në këtë restoran ka qenë tu nejtë me inspektor të tjerë**. Njëri prej tyre quhej Ibrahim Kastrati nga Karaqeva e Epërme, kurse edhe aj tjetri e ka pas emrin Ibrahim por mbiemri nuk i kujtohet. **Ata kishin qenë duke ngrënë bukë**. Në restoran dëshmitari ka hyrë me pi një kafe dhe **rastësisht e ka takuar R. un me dy inspektora tjerë**. E ka pyetur R. un sepse atë e ka njohur më mirë se sa ata dy inspektorat tjerë. **R. u i është përgjegjur se ka mundësi dhe se Rexha i Agi Danit është t’u bajt prej Bujanovcit nëpër doganë dhe dihet që nëse zalli kalon nëpër doganë është me dokumentacion**.

Prej Sh.it **nuk ka blerë zallë** sepse diçka në mes veti kanë obligime dhe siç thuhet në zhargon me tonin është pak ma problem. **E ka lutur R. un që me pyet përmes telefonit “Agi Danin” se a mund të siguroj zallë me dokumentacion afërsisht 200 kubik dhe R. u ka fol me telefon me “Agi Danin”**. Pastaj i akuzuari R. i ka thënë se a ka mundësi mu siguruar zall afërsisht prej 200 kubikëve.

Rastësisht ka ardhë në restoran edhe kushëriri i këtij dëshmitari Sh. Thaqi dhe u ul me ta, pra me dëshmitarin dhe tre inspektorët ku ishte edhe i akuzuari R. . **Sh.i e ka ditë që dëshmitari në fjalë ka nevojë për zall dhe ia ka thënë se transportin ia siguron ai duke e bartur zallin me kamion të tij kuptohet me para dhe ky dëshmitar është pajtuar dhe me atë është marrë vesh që për një kamion në emër të transportit ta paguaj 80 euro edhe atë është marrë vesh që me bajt krejt zallin prej kompanisë “Agi Dani”**.

Sh. Thaçi siç ka theksuar më lart dëshmitarit në fjalë ia ka sjellur një kamion zall që e kishte blerë te kompania A. D.në shumë prej 120 euro dhe i ka thënë se për momentin kompania “Agi Dani” nuk ka **zall me dokumentacion dhe se duhet me prit dhe se Sh.i një kamion zall me sasi prej 10-12 kubikëve ia ka sjellë në fillim të muajit korrik të vitit 2014**. Meqë dëshmitari nuk ka pasur kohë me prit atëherë është përcaktuar që me ble zall me dokumentacion tjetërkund. Kompania “Cofix” me seli në Koretishtë ia ka siguru pjesën tjetër të zallit edhe atë me dokumentacion dhe se ai dokumentacion ka pas të baj më dorëzim të fakturave dhe nuk ka pas dokumentacion tjetër. Kompania “Cofix” me seli në Koretishtë veprimtarin e saj e ka pas thyerjen e gurëve dhe seperimin e tyre.

Në pytjen e kryetarit të trupit gjykues dëshmitari është përgjigjur: se vërtetë a i ka sjellë apo jo dokumentacion Sh. Thaçi për një kamion zallë që ia ka pru e të blerë në kompaninë “Agi Dani” **nuk e din**, sepse ia ka sjellë vetëm një kamion dhe se ka pas faktura sa të duash për t’ia mbuluar Ministrisë së Bujqësisë.

## **5. Provat materiale**

Sipas **Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës** Nr. 02/46 ët datës 02.11 2011 i cili ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit – pra më datën 02.11 2011, edhe atë :

-neni 1. Për ndalimin e eksploatimit të materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

-neni 2. Ndalimi do të zgjas deri në tri vite që nga dita e hyrjes në fui të këtij vendimi ( pra nga data 02.11 2011 deri më 02.11 2014 ),

**-neni 3. Të gjithë operatorët që operojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi do t’u konfiskohet makineria eksploatuese, transportuese dhe materiali inert nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjve, kurse ndaj personave juridik dhe fizik të inicohet procedurë gjyqësore sipas ligjeve në fuqi.**

-neni 4 . Për zbatimin e këtij vendimi obligohen : **Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve**, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe **Komunat përkatëse ( do të thotë edhe Inspektorati në kuadër të Komunës së Kamenicës në të cilin ka punuar edhe i akuzuari R. L.)**.

neni 6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ( pra më datën 02.11 2011 ).

Sipas **Marrëveshjes së bashkëpunimit rreth zbatimit të Vendimit të Qeverisë 2/46 të datës 02.11. 2011** të lidhur në mes të Ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor, Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale dhe OJQ “ Zhavori “ si përfaqësues i operatorëve që eksploatojnë rërë dhe zhavor me **numër të protokollit 1396 të datës 05.04 2012**, është paraparë edhe atë :

**-neni 3. shfrytëzimi i inerteve jashtë shtretërve të lumenjve nga subjektet e licencuara,**

-nënparagrafi **3.1.** Shfrytëzimi i rërës dhe zhavorit nga sipërfaqet për të cilat subjektet e tilla posedojnë licencat nga KPMM dhe pëlqim mjedisor nga MMPH detyrohen që sipas kushteve të përcaktuara në licencë dhe pëlqim mjedisor të vazhdojnë aktivitetin e përkohshëm deri në shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve.

-nënparagrafi **3.2.** Të gjitha ngastrat e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorit nga operatorët që janë në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit të Tokave Bujqësore, nuk ju lejohet asnjë aktivitet i eksploatimit.

-sipas nenit 7 nënparagrafi 7.1 të kësaj Marrëveshje parashihet : të gjithë operatorët që pretendojnë të zhvillojnë aktivitetin e vet për eksploatimin e rërës dhe zhavorit nën kushtet e precizuara në nenin 3 të këtij memorandumit janë të obliguar t’i kenë të kompletuara dokumentacionin sipas dispozitave ligjore nga autoritetet përkatëse. Kurse sipa nënparagrafit 7.2 të të njëjtit nen parashihet : asnjë aktivitet nuk lejohet për asnjë operator pa pajisje me dokumentacion të plotë.

-sipas nenit 8 të kësaj marrëveshje parashihet : për çdo shkelje të dispozitave të Vendimit të Qeverisë dhe dispozitave të memorandumit do të ketë masa ndëshkuese sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe konfiskim të pajisjeve.



-sipas nenit 9 parashihet se marrëveshja – memorandumit hynë në fuqi pas nënshkrimit të palëve të përfshira në këtë marrëveshje përkatësisht që rezultojnë se ka hyrë në fuqi më datën 05.04 2012 siç është cekur më lart tek vula zyrtare me numër të protokollit.

Sipas nenit 15 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 13/01 qershor të vitit 2007, parashihet se toka bujqësore në sistemin e ujitjes nuk mund t'i ndërrohet destinimi i shfrytëzimit përveç ngritjes së objekteve me rëndësi të veçantë publike.

Sipas nenit 13 paragrafi 13.1. b/ të ligjit në fjalë parashihet se ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohen objektet e karakterit të përkohshëm, shfrytëzimi i mineraleve sipërfaqësore, ... dhe mbeturinat e industrisë së drurit. Taka pas një periudhe të caktuar përsëri mund të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

Sipas nenit 56 të **Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet nr. 80/27 gusht 2010** përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ( në tekstin e mëtuftjeshëm KPMM ), bile në kuptim të nenit 56 paragrafi 3 parashihet se : **KPMM i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria.**

Në këtë rast KPMM siç edhe përcaktohet në vendimin e Qeverisë së vendit është përgjegjës për të zbatuar këtë vendim lëndor lidhur me ndalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorit ashtu siç përcaktohet në këtë vendim me datë dhe numër si më lart.

Sipas aktit shkresor me nr. 2662 /11 të datës 05 12 2011 janë njoftuar të gjithë akterët për implementimin e vendimit të Qeverisë nr. 02/2011 të datës 02 nëntor 2011, **se pezullohen** të gjitha pëlqimet mjedisore për operatorët e rërës dhe zhavorit të cilat janë pajisur me pëlqime mjedisore nga MMPH në pajtim me Vendimin përkatës të Qeverisë.

Nga të dhënat e siguruar për tri kompani edhe atë : **SHPK Besi Comerc, SHPK Comi Comerc dhe SHPK Xhelali Trans** sipas listës së distribuimit dokumenti nr. 05-3/605 i datës 08.10 2011 i lëshuar Doganat e Kosovës përkitazi me importimin e rërës dhe zhavorit për këto kompani për periudhën kohore janar 2013 deri më datën 24.11 2014, këto kompani nuk kanë importuar kurrfarë materiali inert – rërë apo zhavor, e bile as kompanitë – operatorët pronarët e të cilëve janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve duke përfshirë edhe dëshmitarin Sh. Thaçi i cili ka punuar në SHPK IMRANI në Muçivrc pronar i të cilit është vëllai i tij Imran Thaçi e kjo konfirmohet me përgjigjen zyrtare në vijim:

-përgjigja zyrtare e Sektorit të inteligjencës dhe analizës së rrishtit – Dogana e Kosovës me numër të referencës Lj-1-063-5078-081014 të datës se për periudhën kohore 2013-14.09 2014 se subjektet në vijim nuk kanë realizuar asnjë import pranë Doganës së Kosovës për periudhën lëndore : “ Koni Kompani “sh.p.k, “ Xhelal Trans “ sh.p.k. dhe Besi Comerc “ sh.p.k.

**-licenca e kompanisë Imrani Company sh.p.k. me pronar Imran Thaçi lidhur me shfrytëzimin me nr. 619/icmm/07 i lëshuar nga KPMM në Prishtinë për periudhën kohore prej 7 viteve edhe atë 12.11 2007 deri më 11.11 2014,**

**Licenca e kompanisë Besi Commerce sh.p.k. me pronar Afrim Spahiu për hulumtime për rërë dhe zhavor për periudhën kohore prej 17.01 2011 deri më 16.01 2013, pastaj licencë për shfrytëzim për rërë dhe zhavor për periudhën kohore nga 06.05 2011 deri më 05.05 2013, licencë për aktivitete të veçanta - për të kryer punët lidhur me seperacionin për periudhën kohore 07.06 2011 deri më 06.06 2014,**

**-përgjigja me shkrim e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë** lidhur me kërkesat e parashtruara me aktvendim të kësaj gjykate të datë 25 shkurt të vitit 2019, edhe atë për periudhën kohore janr 2013 e gjer në fund të vitit 2014 se për cilat kompani kanë lëshuar licenca, e për kompanit pas marrjes së vendimit të qeverisë së vendit të angazhohen subjektet përkatëse e sidomos sipas Memorandumit të bashkëpunimit sipas fushave të përgjegjësisë se a është hartuar plan i veprimit

konform këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi, se për shkalësit e vendimit të Qeverisë çfarë masa janë ndërmarrë sidomos në bashkëpunim me zyrtarin komunal tani të akuzuarin R. L. dhe se a ka evidentuar ndonjë veprim që organi komunal i Komunës së Kamenicës me theks të veçantë të të akuzuarit në fjalë i cili konsiston në tejkalimin e kompetencave të tij ose ndonjë shkelje tjetër zyrtare lidhur me eksploatimin ose transportimin e rërës dhe zhavorit në kuadër të komunës në fjalë të shitur nga kompanitë eksploatuese të zhavorit ose seperimit të rërës në mënyrë ilegale ( ndaj cilave kompani janë ushtruar kallëzime penale nga ky komision).

Në përgjigjen me shkrim të Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale në Prishtinë përmes drejtorit të këtij komisioni të datës 19.03 2019 e të pranuar në këtë datë më 27.03 2019 edhe atë për periudhën kohore 01 janar 2013 e gjer në fund të vitit 2014 në territorin e komunës së Kamenicës janë dhënë këto përgjigje:

-KPMM ka lëshuar licenca apo leje në lidhje me eksploatimin-shfrytëzimin apo seperimin e rërës dhe zhavorit duke përfshirë edhe disa licenca apo leje të cilat janë lëshuar edhe para kësaj periudhe por që afati ligjor i zbatimit të tyre përfshinë periudhën kohore në fjalë. Këtij akti i janë bashkëngjitur në fotokopje edhe licencat apo lejet së bashku me vendimet e KPMM që ndërlidhen me zbatimin e Vndimit nr. 02/46 TË DATËS 02.11 2011 TË Qeverisë së Republikës së Kosovës të operatorëve : - licencë për shfrytëzim dhe licencë për hulumtim për BESI COMERC, po ashtu edhe për operatorin ADICompany, licencë për shfrytëzim dhe leje për aktivitete të vençanta për operatorin Krileva Com dhe licencë për shfrytëzim për operaton Imrani Company dhe licencë për hulumtim për operatorin Dusta Trans,

-KPMM në bazë të kompetencave të tij pas nxjerrjes së vendimit në fjalë nga Qeveria në bazë të kompetencave të saj ka ndërmarr veprime administrative ligjore në përputhje me këtë vendim duke pezulluar disa prej licencave apo lejeve si dhe duke urdhëruar ndërmarrjet të cilat ushtrojnë aktivitet të paligjshëm minerar në ndalimin e këtre aktiviteteve si dhe duke inicuar procedura penale, administrative dhe gjyqësore ndaj kryerësve të këtyre veprave në organet kompetente,

-duke pasur parasysh se në vazhdimësi në komunën e Kamenicës ka pasur aktivitet të jashtëligjshëm minerar, e në këtë rast duke ju referuar periudhës kohore 2011-2014 si rezultat i aktivitetit të jashtëligjshëm minerar në shfrytëzimin dhe seperimin e jashtëligjshëm minerar të rërës dhe zhavorit si dhe duke pasur parasysh edhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër dhe datë të lartcekur, KPMM ashtu siç ka vepruar në tërë territorin e Republikës së Kosovës edhe në Komunën e Kamenicës ka ndërmarr veprime ligjore duke lëshuar urdhëresa ndaj operatorëve ilegal për ndalimin e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare si dhe ka inicuar procedurat penale si dhe ndërmarr inspektimet nga inspektorati i KPMM si rezultat i aktivitetit të jashtëligjshëm minerar dhe moszbatimit të vendimit të Qeverisë. Këtij akti i është bashkëngjitur lista e personave –ndërmarrjeve ndaj të cilave është inicuar procedura penale, janë shqiptuar gjobat administrative si dhe janë lëshuar urdhëresat për ndërprerjen e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare, ku si rezultat i këtyre veprimeve janë ndërmarrë edhe veprime gjyqësore nga ana e gjykatave,

-pas hyrjes në fuqi të vendimit të Qeverisë me numër dhe datë të lartcekur ka pasur edhe disa kërkesa paraprake për licencim ku si rezultat i këtij vendimi këto kërkesa janë refuzuar, e të cilat i janë bashkëngjitur kësaj parashtrëse – përgjigje me shkrim duke përfshirë edhe kërkesat për licencim të hulumtimit së bashku me vendimet e KPMM si rezultat i vendimit të Qeverisë edhe atë për ndërmarrjet : Afërdita Com, Xhelal Trans,

-Inspektorati i KPMM në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Inspektoratet Komunale në tërë territorin e Kosovës ka ndërmarr veprime të inspektimit me qëllim të ndalimit të aktiviteteve të jashtëligjshme minerare duke përfshirë edhe konfiskimin e makinerive dhe mineraleve , e këtu është përfshirë edhe komuna e Kamenicës, ku në regjionin e kësaj komune janë lëshuar disa urdhëresa për konfiskim dhe sekuestrim edhe atë : L. K. vendimi për ndërprerje të aktivitetit ilegal minerar dhe konfiskimin e mjeteve të punës dhe mineraleve të datës 30.06 2012, duke përfshirë edhe vendimet ndaj Dafi Com, H. A., Xh. T., K. Com dhe sh.p.k Koni e që këto vendime janë të vitit 2012 lidhur me ndërprerjen e aktivitetit ilegal minerar dhe konfiskimin e mjeteve të punës dhe mineraleve.

**Në përgjigjen me shkrim lëndore nuk është dhënë kurrëfarë vërejtje në inspektorët e Inspektoratit komunale të komunës së Kamenicës duke përfshirë edhe të akuzuarit R. L. rreth zbatimit të vendimit lëndor të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe**

**Nga Ekspertiza Financiare** e ekspertit financiar Ibrahim Tahiri për periudhën kohore prej janar 2013 e gjer më datën 02 nëntor të vitit 2014 tek kompania “ Afi Dani “ me seli në Ranillug përkatësisht Dheu i Bardhë, lidhur me importimin e rërës dhe zhavorit nga Republika e Sërbisë me kërkesa tjera si në aktvendimin e kësaj gjykate të datës 25 shkurt 2019. **Sipas ekspertizës financiare të ekspertit financiar lidhur me importimin e rërës dhe zhavorit nga Republika e Serbisë nga ana e kompanisë NTP “ A. D.“ me seli në Ranillug për periudhën kohore janar 2013 e deri në nëntor 2014 dhe çështjeve tjera sipas aktvendimit të gjykatës Themelore në Gjilan, rezulton:**

-se kompania “ A. D.“ ka pas veprimtari tjetër ekonomike po jo licencë për nxjerrjen e rërës dhe zhavorit për periudhën kohore 2013-2014 në emër të vet, por ka shfrytëzuar licencën nga blerja e kompanisë shpk “ Belushi “ nga fshati Uglarë, Komuna e Gjilanit e mbështetur në Kontratën për shitblerjen e makinave për prodhimin e gurit ( seperacionit ) të lidhur më datën 07.08 2013,

-gjatë periudhës kohore 2013-2014 është marrë me importimin e rërës dhe zhavorit nga Republika e Sërbisë,

-kompania “ A. D.“ më datën 07.08 2013 ka blerë tërë makinerinë e gurthyesit të kompanisë “ Belush“ shpk. Duke përfshirë edhe linjën për seperimin e rërës dhe zhavorit ( kontratë për shitblerjen për prodhimin dhe përpunimin e gurit –seperacionit ),

-periudha kohore 2013-2014 e veprimtarisë së kompanisë “ A. D.“ është importimi i rërës dhe zhavorit të seperuar nga Republika e Serbisë, e kjo është vërtetuar me dokumentacion valid të DUD-ave Doganor tek Shpedicioni “ Vjosa “ në Dheun e Bardhë dhe në pikën doganore në të njëjtin vend, të cilat i janë bashkëngjitur ekspertizës financiar, por kjo është vërtetuar edhe sipas të dhënave në Librin e blerjes në të cilën janë evidentuar DUD-at Doganor për importimin e rërës dhe zhavorit nga Republika e Sërbisë,

-shpk “ A. D.“ ka importuar nga Republika e Sërbisë rërë gjatë periudhës kohore 12.02 2013 deri më 31.10 2014, edhe atë gjatë vitit 2013 ka importuar rërën 9,944 kubik nga të cilat i ka shitur 9,637.42 kubik, ndërsa në stoqe kanë mbetur 306.58 kubik, kurse gjatë vitit 2014 ka importuar rërë 10,790.67 kubik nga të cilat i ka shitur 8,916.00 kubik, ndërsa në stoqe kanë mbetur 1,874.67 kubik,

**-Blerësi i rërës dhe zhavorit nga kompania “ A. D.“ shpk janë : 15 komani në mesin e të cilave asnjëra prej kompanive në dispozitivin e aktakuzës nuk gjendet, por edhe i personave privat sipas fletdërgesave, e në mesin e tyre nuk gjendet personi me emrin A. siç ceket në transkript të masave të fshehta, bile gjatë ekzaminimit nuk është gjetur as fletdërgesë në të cilën është paraqitur si blerës qytetari tani dëshmitari Sabri Thaçi nga fshati Muqivërc, Komuna e Kamenicës për ndërtimin e fermës si donacion nga Ministria përkatëse, por as kompanit e lartcekura: “ I. Commerce “, “ B. C. “, “ Xh. T.“ , “C. C.“ dhe “ K. Com “ me seli në territorin e Komunës së Kamenicës.**

Në ekspertizë janë prezentuar edhe çmimet e zhavorit për një ton gjatë vitit 2013 dhe 2014, të cilat kanë lëvizur varësisht prej intervalit kohor, por sipas faturës nr. F-36ER/2013 të datës 05.07 2013 çmimi i zhavorit përkatësisht rërës me TVSH për një metër kub është 18,00, pastaj sipas faturës nr. 17ER/2014 çmimi i zhavorit përkatësisht rërës me TVSH 1 ( 0-4mm ) i datës 20.03 2014 për një metër kub është 18,00.

Pra, çmimet e zhavorit merren parasysh varësisht prej madhësisë milimetrike të zhavorit përkatësisht rërës por edhe të distancës të vendit të destinacionit por edhe të shpenzimeve të transportit ( nëse eventualisht blerësi e transporton me kamion transportues të vet çmimi është më i lirë dhe e kundërta. Rimorkioja e kamionit transportues mund të jetë prej 15 – 18 metra kub zhavor përkatësisht rërë.

**Ekspertizës financiare i janë bashkëngjitur edhe fotot e bëra të vendit të eksploatimit të rërës dhe zhavorit si dhe fotot e makinerisë së prodhimit të rërës dhe zhavorit në fshatin Koretishë, Komuna e Novo Bërdës.**

**Eksperti financiar I. T.** në seancë të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se sipas ekspertizës lëndore kompania “ A. D.“ nuk ka licencë për nxjerrjen e rërës dhe zhavorit për periudhën kohore 2013-2014 në emër të vet, por që ka shfrytëzuar licencën e një kompanie tjetër që e ka blerë ( sqarimet e lartcekura në ekspertizën financiare ). Pëlqim për eksploatimin e rërës dhe zhavorit ka pas vetëm në

vitin 2010 përkatësisht për periudhën kohore duke filluar nga 20.05 2010 dhe ky pëlqim ka vlejtur vetëm për një vit. Në ekspertizë janë prezentuar edhe kompanitë edhe personat fizik që kanë blerë rërë dhe zhavor nga kompania “ Agi Dani“.Fotot e bashkëngjitura ekspertizës janë bërë sipas aktvendimit të kësaj gjykate. Në pjesën e fotografuar të lumit krivarekë për shkak të eksploatimit të rërës dhe zhavorit është bërë zgjerimi i theksuar i shtratit të lumit, mirëpo duke pasur parasysh gjenden në të cilën gjendet shtrati i lumit ku kishte bimë dhe shkurre të ndryshme të drunjëve jep me kuptua se gjatë vitit 2013 dhe 2014 nuk është bërë eksploatimi i rërës dhe zhavorit të shtatit të këtij lumi.Fotot i ka bërë jashtë vendit ku ka qenë ura por në drejtim të fshatit Ranillug por edhe përgjatë rrjedhjes së lumit deri në derdhje të këtij lumi në lumin Morava, por foto nuk ka bërë në drejtim tjetër të lumit Krivareka.

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit tek kompania A. D.nuk ka has ndonjë rast që tregon se në mënyrë jo të rregullt të ju kish shitur rërë apo zhavor personave privat edhe atë pa dokumentacion. Gjatë kontrollimit të dokumentacionit unik doganor për periudhën kohore të cekur në aktvendim ( 2013-2014 ) lidhur me importimin e rërës dhe zhavorit si ekspert nuk ka hasur ndonjë parregullësi. Kjo kompani nuk ka pas ndonjë vend tjetër nga i cili i ka furnizuar blerësit me rërë dhe zhavor sipas dokumentacionit të kontrolluar. Degradimi i terrenit edhe atë në vendin ku janë bërë fotot ( lumi Krivareka ) ka mundur të bëhet edhe para periudhës kohore 2013-2014 me arsyetim se për eksploatimin e rërës dhe zhavorit kanë mundur me pas licenca edhe kompanit tjera e të cilat nuk i ka pas objekt ekspertimi. Në bazë të dokumenteve unike doganore rëra dhe zhavori i importuar nga Republika e Serbisë ka qenë **i seperuar edhe atë në tërësi**. DUD-in e shfrytëzojnë sipas rregullit vetëm kompanitë importuese dhe se i njëjti shërben për regjistrimin kontabël në kompanin importuese.

## 6. Faktet kontestuese dhe jo kontestuese

### Faktet kontestuese lidhur me çështjen penale lëndore janë :

-përmbajtja e transkripteve sipas masave të fshehta ku përmes telefonit gjatë periudhës kohore të tyre ka biseduar i akuzuari me akter tjerë a ndërlihet me ndonjë provë tjetër të besueshme dhe të mjaftueshme se vërtetë ashtu siç ka biseduar me këta akter edhe është vepruar faktikisht,

-personi me emrin A. e ka mbiemrin Th. apo ndonjë mbiemër tjetër, ka qenë blerës i rërës dhe zhavorit, transportues i tyre apo importues i tyre nga territori i Republikës së Serbisë apo nga importuesi “ A. D.“,

-a ka blerë vërtetë rërën dhe zhavorin për ngritjen e fermës së lopëve dëshmitari Sabri Thaçi nga kompania “ A. D.“ apo nga ndonjë firmë tjetër sipas dokumentacionit të rregullt,

-rërën dhe zhavorin ia ka bartur kusheriri i tij Sh. Thaçi me kamionët e tij apo jo dhe sa është sasia e bartur e rërës dhe zhavorit, por edhe çmimi për një metër kub të zhavorit përkatësisht rërës,

-kush ka realizuar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme nga rëra apo zhavori i eksploatuar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe marrëveshjes së mirëkuptimit me numra të protokollit dhe data të lartcekura. Cilat janë ato kompani apo cilët janë ata persona fizik. ( kuptohet sipas përshkrimit faktik të akuzës në aktakuzën lëndore a janë ndonjëra prej kompanive : Imrani Commerce, Besi Com, Agi Dani, Komi Company, Xhelai Trans apo Krileva Com, apo ndonjë person fizik nëse vërtetohet me prova të plota, të besueshme dhe të lejueshme,

-ka keqpërdor autorizimet e tij i akuzuari për periudhën kohore gjer sa ka qenë në fuqi vendimi i Qeverisë së vendit me të cilin është ndaluar eksploatimi i rërës dhe zhavorit në territorin e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë duke përfshirë territorin e Komunës së Kamenicës, apo i ka tejkualuar të njëjtat me qëllim që vetit apo **tjetrit t'i sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme apo që t'i shkaktoj ndonjë dëm në çfarëdo forme,**

-i akuzuari ju ka dhënë apo jo këshilla apo instruksione sipas përmbajtjes së transkripteve pronarëve apo punëtorëve të operatorve për eksploatimin e rërës dhe zhavorit për sigurimin e dokumentacionit nga kompanit importuese në mënyrë që pastaj të njëjtin ta shfrytëzojnë edhe herave tjera për transportimin e rërës dhe zhavorit,

-bartja e rërës dhe zhavorit me mjet transportues nëse pronari apo i autorizuari i tij qëftë operator ekonomik qoftë person fizik nëse nuk posedon dokumentacion valid për transportimin e rërës dhe zhavorit, a trajtohet apo jo, si eksploatim i rërës dhe zhavorit në mënyrë të kundërligjshme përkatësisht në kundërshtim me Vendimin e Qeverisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit me numër të protokollit dhe datë, muaj dhe vit të lartëcekur,

-është e detyrueshme marrëveshja për zbatimin e Vendimit të lartcekur të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe a bie ndesh me vendimin në fjalë apo jo .

### **Faktet jo kontestuese**

-se vërtetë i akuzuari për periudhën kohore për të cilën akuzohet ka pas cilësinë e personit zyrtar nuk kontestohet nga i akuzuari, por ky fakt relevant mbështetet edhe në nenin 120 paragrafi 1 nënparagrafi 2 pika 2.3 të KPRK-s,

-përmbajtja e transkripteve është reale sa i përket bisedave të zhvilluara mes të akuzuarit dhe akterve tjerë, dhe përputhet me CD të riprodhuar gjatë sreancës së shqyrtimit gjyqësor,

-me vendim të Qeverisë së vendit është ndaluar eksploatimit i rërës dhe zhavorit nga operatorët ekonomik të gjithë vendit për periudhën kohore sipas këtij vendimi, pra duke përfshirë edhe ata që operojnë në kuadër të territorit të Komunës së Kamenicës,

-marrëveshja për zbatimin e vendimit të Qeverisë së vendit është lidhur mes akterve si në shkresa të lëndës pas nxjerrjes së vendimit të Qeverisë,

-se sipas deklaratave të pronarve të operatorëve ekonomik Imrani Commerce dhe Besi Com të cilët janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve këto dy kompani nuk janë importuese të rërës dhe zhavorit nga territori i Republikës së Serbisë apo të ndonjë vendi tjetër,

- se sipas përgjigjes zyrtare të Sektorit të Inteligjencës dhe Analizës së Riskut – Dogana e Kosovës me numër të referencës Lj-1-063-5078-081014 operatorët ekonomik të Komunës së Kamenicës për periudhën kohore 2013-14.09 2014 **nuk kanë realizuar asnjë import ( të rërës apo zhavorit ) pranë Doganës së Kosovës edhe atë : “ Koni Kompani “sh.p.k, “ Xhelal Trans “ sh.p.k. dhe Besi Comerc “ sh.p.k.**

-KPMM në përgjigjen e saj zyrtare të kërkuar nga kjo gjykatë nuk e ka njoftuar gjykatën për ndonjë vërejtje ndaj të akuzuarit si zyrtar komunal lidhur me ndonjë parregullësi gjatë periudhës kohore sipas Vendimit të Qeverisë së vendit.

### **7. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit dhe provave të administruara dhe nxjerrja e përfundimeve lidhur me faktet relevante të vërtetuara apo të pavërtetuara lidhur me çështjen penale lëndore**

Sa i përket fakteve jo kontestuese të paraqitura më lart në këtë arsyetim të aktgjykimit gjykata nuk do të jap arsyetim të posaçëm, meqë përmbajtja e tyre rezulton nga shkresat e lëndës e cila edhe nuk mund të kontestohet nga asnjëra prej palëve.

Ndërsa sa i përket fakteve kontestuese lidhur me të njëjtat në mënyrë detale do të jepet arsyetim përkatës.

Gjykata ka vlerësuar se mbrojtja e të akuzuarit R. lidhur me atë se me veprimet e tij as nuk ka keqpërdor detyrat apo autorizimet ligjore e as nuk ka tejkalluar autorizimet e tij si inspektor komunal në Komunën e Kamenicës duke e vlerësuar në kontekst me provat tjera personale dhe materiale por edhe lidhur me vendimin e Qeverisë me të cilin është ndaluar eksploatimi i rërës dhe zhavorit në tërë territorin e Republikës së Kosovës por edhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, pjesërisht është e besueshme me arsyetim si në vijim :

-është e vërtetë se nga vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/46 të datës 02.22 2011 i cili ka hyrë në fuqi ditën e ndëshkrimit, pra më datën 02.11 2011,

-sipas nenit 1.të këtij vendimi është ndaluar eksploatimi i materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjëve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës,

-sipas nenit 2 të këtij vendimi parashihet se ndalimi do të zgjas deri në tri vite ( pasi që me nenin 6 është paraparë se ky vendim hynë në fuqi më 02.11 2011, periudha tri vjeçare përfshinë intervalin kohor nga 02.11 2011 e deri më 02. 11 2014,

-sipas nenit 3 të këtij vendimi parashihet se të gjithë operatorët që operojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi do t'u konfiskohet makineria eksploatuese, transportuese dhe materiali inert nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjve, kurse ndaj personave juridik dhe fizik të inicohet procedurë gjyqësore sipas ligjeve në fuqi,

ndërsa përjashtimet janë paraparë me dispozitatat e marrëveshjes së Bashkëpunimit me arsyetimi në vijim :

-sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit rreth zbatimit të vendimit të Qeverisë 2/46 të datës 02.11 2011 të lidhur në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe OJQ “ Zhavori “ si përfaqësues i operatorëve që eksploatojnë rërë dhe zhavor me numër të protokollit 1396 të datës **05.04 2012**, është paraparë edhe atë :

### **-neni 3. shfrytëzimi i inerteve jashtë shtretërve të lumenjve nga subjektet e licencuara,**

-nënparagrafi **3.1. Shfrytëzimi i rërës dhe zhavorit nga sipërfaqet për të cilat subjektet e tilla posedojnë licencat nga KPMM dhe pëlqim mjedisor nga MMPH detyrohen që sipas kushteve të përcaktuara në licencë dhe pëlqim mjedisor të vazhdojnë aktivitetin e përkohshëm deri në shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve.**

-nënparagrafi **3.2.** Të gjitha ngastrat e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorit nga operatorët që janë në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit të Tokave Bujqësore, nuk ju lejohet asnjë aktivitet i eksploatimit.

-sipas nenit 7 nënparagrafi 7.1 të kësaj Marrëveshje parashihet : të gjithë operatorët që pretendojnë të zhvillojnë aktivitetin e vet për eksploatimin e rërës dhe zhavorit nën kushtet e precizuara në nenin 3 të këtij memorandumi janë të obliguar ta kenë të kompletuar dokumentacionin sipas dispozitave ligjore nga autoritetet përkatëse. Kurse sipa nënparagrafit 7.2 të të njëjtit nen parashihet :

**asnjë aktivitet nuk lejohet për asnjë operator pa pajisje me dokumentacion të plotë.**

-sipas nenit 8 të kësaj marrëveshje parashihet : **për çdo shkelje të dispozitave të Vendimit të Qeverisë dhe dispozitave të memorandumit do të ketë masa ndëshkuese sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe konfiskim të pajisjeve.**

-sipas nenit 9 parashihet se marrëveshja – memorandumi hynë në fuqi pas nënshkrimit të palëve të përfshira në këtë marrëveshje përkatësisht që rezulton se ka hyrë në fuqi më datën **05.04 2012** siç është cekur më lart tek vula zyrtare me numër të protokollit.

Sipas nenit 15 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 13/01 qershor të vitit 2007, parashihet se toka bujqësore në sistemin e ujëtjes nuk mund t'i ndërrohet destinimi i shfrytëzimit përveç ngritjes së objekteve me rëndësi të veçantë publike.

Sipas nenit 13 paragrafi 13.1. b/ të ligjit në fjalë parashihet se ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohen objektet e karakterit të përkohshëm, shfrytëzimi i mineraleve sipërfaqësore, ... dhe mbeturinat e industrisë së drurit. Taka pas një periudhe të caktuar përsëri mund të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

Sipas nenit 56 të **Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet nr. 80/27 gusht 2010** përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ( në tekstin e mëtuftjeshëm KPMM ), bile në kuptim të nenit 56 paragrafi 3 parashihet se : **KPMM i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria.**

Në këtë rast KPMM siç edhe përcaktohet në vendimin e Qeverisë së vendit është përgjegjës për të zbatuar këtë vendim lëndor lidhur me ndalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorit ashtu siç përcaktohet në këtë vendim me datë dhe numër si më lart.

Sipas aktit shkresor me nr. 2662 /11 të datës 05 12 2011 janë njoftuar të gjithë akterët për implementimin e vendimit të Qeverisë nr. 02/2011 të datës 02 nëntor 2011, se **pezullohen** të gjitha pëlqimet mjedisore për operatorët e rërës dhe zhavorit të cilat janë pajisur me pëlqime mjedisore nga MMPH në pajtim me Vendimin përkatës të Qeverisë.

Nga të dhënat e siguruar për tri kompani edhe atë : **SHPK B. Comerc, SHPK C. Comerc dhe SHPK Xh. Trans** sipas listës së distribuimit dokumenti nr. 05-3/605 i datës 08.10 2011 i lëshuar Doganat e Kosovës përkitazi me importimin e rërës dhe zhavorit për këto kompani për periudhën kohore janar 2013 deri më datën 24.11 2014, këto kompani nuk kanë importuar kurrfarë materiali inert – rërë apo zhavor, e bile as kompanitë – operatorët pronarët e të cilëve janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve duke përfshirë edhe dëshmitarin **Sh. Th. i cili ka punuar në SHPK I. Commerce me seli në Muçivrc, pronar i të cilit është vëllai i tij I. Th. e kjo konfirmohet me përgjigjen zyrtare në vijim:**

-përgjigja zyrtare e Sektorit të inteligjencës dhe analizës së rrishtit – Dogana e Kosovës me numër të referencës Lj-1-063-5078-081014 të datës se për periudhën kohore 2013-14.09 2014 se subjektet në vijim nuk kanë realizuar asnjë import pranë Doganës së Kosovës për periudhën lëndore : “ **Koni Kompani “sh.p.k, “ Xhelal Trans “ sh.p.k. dhe Besi Comerc “ sh.p.k.**

-licenca e kompanisë **L, C, sh.p.k.** me pronar **I, Th,** lidhur me shfrytëzimin me nr. 619/icmm/07 i datës 12.11 2009 e lëshuar nga KPMM në Prishtinë për periudhën kohore prej 7 viteve edhe atë 12.11 2007 deri më 11.11 2014,

Mirëpo, pjesa tjetër e mbrojtjes së të akuzuarit **R. L.** nuk është aporvuar nga gjykata sepse e njëjta është në kundërshtim me provat e administruara edhe atë si me ato personale ashtu edhe materiale, dhe veprimet e të akuzuarit janë vlerësuar si inkriminuese e që konsumojnë veprën penale e cila i është vënë në ngarkesë me aktin akuzues lëndore, me arsyetim si në vijim :

-sipas nenit 422 paragrafi 1. të Kodit penal të Republikës së Kosovës ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/13 Korrik 2012, Prishtinë ) parashihet se :

**personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktoj dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë ( 6 ) muaj deri në pesë ( 5 ) vjet.**

Në vijim do të jepet arsyetim lidhur me faktet relevante të vërtetuara me provat e administruara e të cilat paraqesin elemente të figurës së veprës penale lëndore.

**A trajtohet i akuzuari si person zyrtar në kohën kur ka ndërmarr veprimet për të cilat akuzohet për veprën penale lëndore? Vet i akuzuari ka pranuar se në Komunën e Kamenicës ka punuar në cilësi të inspektorit komunal të resurseve natyrore gjer më datën 24 prill të vitit 2014 ndërsa prej datës 25 prill 2014 në cilësi të përgjegjës të Inspektoratit Komunal në Kamenicë.**

**Se vërtetë ky i akuzuar në periudhën e lartcekur kohore ka pasur cilësinë e personit zyrtar vërtetohet sipas kapitullit XIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës edhe atë me nenin 120 paragrafi 1 nënparagrafi 2. pika 2.3 të KPRK-s fakt ky relevant edhe nuk është kontestues nga i akuzuari.**

**Sipas nenit 5 të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër dhe datë të lartcekur parashihet :**

**për zbatimin e këtij vendimi obligohen : Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komunat përkatëse . Sipas kësaj dispozite rezulton se Inspektorët komunal, pozitë kjo zyrtare edhe e të akuzuarit si si inspektor komunal i resurseve natyrore gjer më 24 prill 2014 në Kamenicë, e pastaj nga data 25 prill 2014 në cilësi të përgjegjës të Inspektoratit Komunal në Kamenicë, është përfshirë në detyrat e zbatimit të Vendimit lëndor të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër dhe datë të lartcekur. Tanimë ky fakt nuk është kontestues, sepse rezulton nga arsyetimi i mësipërm, e këtë nuk e ka kontestuar as i akuzuari, edhe pse sipas raporteve policore të cekura në këtë arsyetim të aktgjykimit kur nuk ka qenë i interesuar për të intervenuar si inspektor komunal kur është ftuar nga policia për të dal në vend të ngjarjes për të verifikuar se personat e ndalur me kamionët transportues a posedojnë dokumentacion valid për transportimin e rërës dhe zhavorit, policin e ka udhëzuar që të ftoj zyrtarët e Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale në Prishtinë, duke i ftuar edhe vet si person zyrtar përmes telefonit mobil.**

Vlen të theksohet se sipas autorizimeve të dhëna në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe atë nenit 6, është lidhur edhe Marrëveshja e bashkëpunimit rreth zbatimit të Vendimit lëndor të Qeverisë me numër të protokollit 1396 më datën 05.04 2012 në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësiror , Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe OJQ “ Zhvori “ si përfaqësuese legjitime e operatorëve të eksploatimit të rërës dhe zhavorit duke u pajtuar dhe marr obligime për zbatimin e plotë të Vendimit të Qeverisë me numër 02/46,

MIRËPO ME NENIN 3 PARAGRAFI 3.1 TË KËSAJ MARRËVESHJE është paraparë :

Shfrytëzimi i rërës dhe zhavorit nga sipërfaqet për të cilat subjektet e tilla posedojnë licencë nga KPMM-ja dhe pëlqim mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësiror, janë të autorizuar të veprojnë sipas kushteve të përcaktuara në licencë dhe pëlqimit mjedisor për të vazhduarë aktivitetin e përkohshëm deri në shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve. Mirëpo me nenin 7 paragrafi 7.1 të kësaj marrëveshje është paraparë : të gjithë operatorët që pretendojnë të zhvillojnë aktivitetin e vet për eksploatimin e rërës dhe zhavorit nën kushtet e precizuara në nenin 3 të këtij memorandumi - marrëveshje bashkëpunimi janë të obliguar ta kenë të kompletuar dokumentacionin sipas dispozitave ligjore nga autoritetet përkatëse.

Pra, sipas nenit 3. të Vendimit të Qeverisë operatorët si eksploatues të rërës dhe zhavorit , të cilët operojnë pa dokumentacion të kompletuar pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi përkatësisht të memorandumit të bashkëpunimit në fjalë,

**do t’ju konfiskohet makineria eksploatuese, transportuese dhe materiali inert nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjëve në pajtim me ligjin, përkatësisht po qe se nuk ju përmbahen kushteve të përcaktuara në licencë dhe pëlqimit mjedisor për shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve edhe pse e kanë të siguruar licencën por vetëm për sipërfaqet e lejuara e jo jashtë tyre.**

**Në rastin konkret sipas përmbajtjes së transkripteve të administruara si prova materiale, përmbajtja e të cilave përputhet në tërësi me përmbajtjen e bisedave telefonike mes të akuzuarit R. dhe akterëve tjerë të cilët do të identifikohen në vijim duke u ndërlidhur edhe me provat tjera të administruara, i akuzuari ka dhënë instruksione se si operatorët ekonomik për eksploatimin e rërës**



**dhe zhavorit në komunën e Kamenicës të sigurojnë dokumentacion jo valid ose se si duke shfrytëzuar dokumentacion jo valid të transportojnë rërë dhe zhavor, kur të ndalen nga policia me arsyetim si në vijim :**

-sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor me lejen e gjykatës prokurori i shtetit ka lexuar transkriptin e datës 01.07 2014 me fillim në ora 12,35 minuta edhe atë si në vijim “ **R. u e thirr në telefon njëfarë R.in që tani për tani për ne është i panjohur dhe nga i njëjti kërkon që t’ia rregullon disa dokumente doganore për disa kubik zall. R. u kërkon dokumentacion për një person të tretë edhe atë 200 kubik zall po ai ( mendohet në R.in ) premtun njëherë për 20 kubik zall dhe e lënë të takohen në Rogoçicë tek Kafiteria e Velisë**”. Më tutje prokurori i shtetit këtë përmbajtje të lexuar deklaroi se mund ta mbështes edhe në riprodhimin e përmbajtjes së këtyre fjalëve në CD-n ku edhe dëgjohet zëri i bisedave telefonike në mes të R. L.t dhe R. V.t, pasi që njëkohësisht në seancën e kaluar ka propozuar që CD-ja e bisedave telefonike në mes të të akuzuarit R. L.t dhe R. V.t si dhe dëshmitarëve tjerë eksploatues të rërës të administrohet si provë.

-sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor dëshmitari **R. V.** është dëgjuar dy herë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor si pronar i kompanisë “ A. D.“ me seli në Gjilan rruga “ R. Mala “ nr. 34, i cili ka separacion edhe në Ranillug – te Dheu i Bardhë, dhe se i njëjti posedon SIM kartelën me nr.044 575736, dhe se ka deklaruar se ka qenë i njoftuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorit.

Ky dëshmitar është dëgjuar më datën 13 prill 2016, ku ka mohuar se ka raporte miqësore apo shoqërore me R. L.n dhe se pas leximit të transkriptit të bisedës telefonike të numrit të lartcekur dhe numrit 044 231000 lidhur me bisedën mes R. L.t dhe të këtij dëshmitari, dëshmitari ka deklaruar se R. u për Sh. Th. ka kërkuar 200 kubik zall por dëshmitari i ka premtuar vetëm 20 kubik sepse nuk ka mundur me i siguruar më shumë prej Serbisë dhe se e kanë lanë me u takuar në Rogoçicë tek kafiteria e Velisë. Dëshmitari ka shtuar edhe këtë se shoferat e mi me kamion transportues ia kanë dërguar 20 kubik zall të shtalla në fshatin Muçivrc por zall i ka dërguar edhe herave tjera.

Në pyetjen e prokurorit ky dëshmitar është përgjigjur se ka siguruar zall me letra prej Serbisë dhe nuk mund të sqarohet se pse R. u ka kërkuar dokumentacion për zall për Sh. Th.. Ka deklaruar edhe këtë se ka siguruar zall me dokumentacion valid nga Serbia, dhe mban evidencë të rregullt për dokumentacionin rreth furnizimit me zhavor nga Serbia.

Në deklaratën e këtij dëshmitari – **R. V.** të dhënë në seancë më datën 11 nëntor 2016 – pas pyetjes së parashtruar nga prokurori i shtetit – se me vet faktin se deklarata e juaj e dhënë në Polici dhe gjatë shqyrtimit të kaluar gjyqësor lidhur me këtë çështje penale por edhe nga raporti shtesë i hetuesit të Policës së Kosovës është kontradiktore, a keni biseduar me R. un për sigurimin e 200 kub zall me dokumentacion përcjellës për Sh. Th., dëshmitari R. V. ka deklaruar se kemi biseduar por unë jam marr vesh për 20 kubik e jo për 200 kubik .

Në pyetjen tjetër se a i keni dërguar zall Sh. Th. sipas kërkesës së R. L.t ky dëshmitar është përgjigjur jo pra as zall e as dokumentacion përcjellës dhe se nuk e din se për çka R. u ka kërkuar rërë dhe dokumentacion prej tij për Sh. Th..

Me lejen e gjykatës prokurori i shtetit ka lexuar transkriptin e datës 01.07 2014 me fillim në ora 12,35 minuta edhe atë si në vijim “ **R. u e thirr në telefon njëfarë R. që tani për tani për ne është i panjohur dhe nga i njëjti kërkon që t’ia rregullon disa dokumente doganore për disa kubik zall. R. u kërkon dokumentacion për një person të tretë edhe atë 200 kubik zall po ai ( mendohet në R. ) premtun njëherë për 20 kubik zall dhe e lënë të takohen në Rogoçicë tek Kafiteria e Velisë**”. Më tutje prokurori i shtetit këtë përmbajtje të lexuar deklaroi se mund ta mbështes edhe në riprodhimin e përmbajtjes së këtyre fjalëve në CD-n ku edhe dëgjohet zëri i bisedave telefonike në mes të R. L.t dhe R. V.t, pasi që njëkohësisht në seancën e kaluar ka propozuar që CD-ja e bisedave telefonike në mes të të akuzuarit R. L. dhe R. V.t si dhe dëshmitarëve tjerë eksploatues të rërës të administrohet si provë.

Me leje të gjykatës prokurori i shtetit këtë dëshmitar e ka ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë në prokurori më datën 05.11 2014 edhe atë në faqen 3 pasuesi i 5 edhe atë **“meqenëse R. un e njihni vetëm si person zyrtar përkatësisht inspektor në Kamenicë, për çfarë arsye është bërë kjo bisedë e datës 01.07 2014 me përmbajtjen siç u theksua në deklaratën e dhënë në prokurori më datën e lartcekur, dëshmitari R. është përgjigjur : nuk mund të sqarohem për këtë por unë kam kuptuar ashtu siç cekta më lart** ndoshta i ka lyp për 200 kubik zall por unë e kam kuptuar për 20 kubik zall dhe se R. un e njoh si inspektor në Kamenicë, nuk kemi raporte të afrëta me te.

Në pyetjen intervenuese të kryetarit të trupit gjykues dëshmitari R. V. është përgjigjur : “ e vërtetë është ajo që po them tani se vërtetë nuk e kam ditur se R. L. ka qenë zyrtar po inspektor i Kamenicës.

Në pyetjen sqaruese të prokurorit të shtetit, dëshmitari R. është përgjigjur se **unë gjatë vitit 2010 nuk e kam ditur se R. u është inspektor.**

Gjykata nuk ia ka fal besimin dëshmitarit R. V. sepse deklarata e tij është në kundërshtim me transkriptin e bisedës telefonike të datës 01.07 2014 të zhvilluar mes të akuzuarit R. dhe dëshmitarit R. V., edhe atë me përmbajtje si në vijim : “ “ R. u e thirr në telefon njëfarë R. që tani për tani për ne është i panjohur dhe nga i njëjti kërkon që t’ia rregullon disa dokumente doganore për disa kubik zall. R. u kërkon dokumentacion për një person të tretë edhe atë 200 kubik zall po ai ( mendohet në R.in ) premtom njëherë për 20 kubik zall dhe e lënë të takohen në Rogoçicë tek Kafiteria e Velisë”, e cila përputhet në tërësi me përmbajtjen e riprodhuar të CD në të cilën është dëgjuar zëri i këtyre dy personave, e këtë nuk e ka kundërshtuar i akuzuari me mbrojtësin e tij.

Nga deklarata e këtij dëshmitari të dhënë para prokurorit të shtetit të datës 05.11 2014 faqe 3 pasuesi 5 rezulton se:

dëshmitari R. e ka ditur se në telefon është duke biseduar me R. L. si person zyrtar përkatësisht inspektor në Kamenicë, të cilës ia ka fal besimin meqë me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë e ka deklaruar këtë përmbajtje, pa presion dhe shtrëngim nga askush, edhe pse gjatë shqyrtimit gjyqësor është përpjekur që të bëjë mohimin e kësaj përmbajtje kinse se nuk e ka ditur se R. u është person zyrtar përkatësisht inspektor, pastaj herë se ai ka porosit përmes telefonit zall në sasi prej 20 kubik, por herë se kinse me transportuesit e tij ia ka dërguar zallin bile edhe herave tjera, e në anën tjetër nga ekspertiza financiare e ekspertit financiar rezulton se në mënyrë të rregullt me dokumentacion valid rërë dhe zhavor nuk i ka dërguar as kusheririt të dëshmitarit Sh. Th. edhe atë S. Th., as operatorit ekonomik “ B. Commerce e as personit me emrin A. mbiemri i të cilit as gjykatës e as prokuroris nuk i është i njohur, por edhe pronar i cilit operator eventual është.

Nga kjo gjykata ka nxjerr përfundimin se kompania “ A. D. “ në bazë të ekspertizës financiare të bërë nga eksperti financiar I. T. Ecc. i diplomuar me përvojë shumëvjeçare në këtë lëmi, me dokumentacion valid përmes dëshmitarit Sh. Th. nuk ia ka dërguar një kamion rërë prej 18 metra kubik dëshmitarit S. Th.. Për ta mbështetur këtë përfundim zyrtar gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit Sh. Th. por edhe të dëshmitarit S. Th. si dhe të raportit policor të datës së lartcekur kur nga policia është ndaluar kamioni transportues MAN të cilin e ka drejtuar dëshmitari Sh. Th. edhe atë si në vijim :

**Dëshmitari Sh. Th.** – ka deklaruar në tërësi si në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori dhe se kompania “ Imrani me seli në Muqivrc është pronë e vëllait të tij I. Th. por aty edhe ky punon, se ka qenë në dijeni për vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorit, por kjo kompani ka qenë e pajisur me dokumentacion valid. Posedon numrin e telefonit 044 ..... por e din edhe numrin e R. L. t e që është regjistruar 044 ..... Gjatë ballafaqimit të tij nga prokurori i shtetit me **transkriptin e bisedës telefonike më datën 02.07 2014 edhe atë me numrat e telefonit si më lart edhe atë rreth orës 14:20 me përmbajtje si në vijim :**

“ o shef a je bre “ i njëjti ia ka kthen duke i thënë “ fol “ dhe fillimisht pasi që e përshëndesin njëri tjetrin, personi N.N. e që është dëshmitari në fjalë ( Sh. Th. ) **thotë duke i treguar se “ kjo e kshyra unë ish deri në muajin 11 të vitit 2014, deri në dimër, Inspektori ( R. L. ) i thotë “ boja një kopje**

qati dosti duke i thënë ngomë mua çka pot thom dhe i tregon duke i thënë le ti thotë se ajo ka vlej për ata që skan fare licenca, njëherit i thotë mos i trego që të kam que unë ( vërejtje : R. L. ) edhe e sugjeron duke i thënë qato letrat boni patjetër, pala i thotë po po veç të nesërmën në mëngjes se sot nuk mundem, pastaj inspektori ( vërejtje : R. u ) i thotë : “qato letra me sabah i bon me vete dhe u bitis, njëherit i thotë se kur të vij në ata mos u dorëzo i thu që unë i kom pi doganës pra kur të vij në ata ja qet letrat edhe i thu qe i ke prej doganës për neve, në fund i thotë shtërngov njëherë tani “. Në pyetjen e prokurorit lidhur me sqarimin e këtij traskripti – dëshmitari është përgjigjur unë kam kërkuar zhavor me dokumente sepse ai ka bajt prej Serbisë zhavor edhe atë nga R. V. pronar i firmës “ A. D. “me seli te Dheu i Bardhë, sqarime tjera nuk kam”. Nuk i kujtohet se a ka bërë biseda tjera me R. L.

Pastaj, prokurori i shtetit e ka njoftuar këtë dëshmitar me përmbajtjen e një raport policor të datës 08.07 2014 rreth ndaljes së automjetit transportues MAN me targa 629 KS 127 i ngarkuar me 15 metra kub zhavor, dhe se policia e ka njoftuar Inspektorin R. L. i cili ka qenë në vend të ngjarjes, dëshmitari Sh. Thaçi përgjigjet : se zalli nuk është marr sepse unë kam poseduar dokument edhe atë kam pas licencë dhe se ajo sasi është marr te kompania A. D. në Crep ( vërejtje : Dheu i Bardhë ) dhe se kjo rërë ka qenë duke u dërguar te firma në Muçivërc tek kushëriri im S. Th. me sa e di ai me dokumentacion të rregullt e ka siguruar një sasi të caktuar edhe atë me dokumentacion të rregullt doganor. Më tutje deklaroi se kamioni me zhavor është liruar nga ana e policisë dhe inspektorit R. L. pasi që unë kam pas në posedim dokumentacionin e rregullt.

Këtë dëshmitar e ka ballafaquar prokurori i shtetit me transkriptet e bisedës telefonike më datën 07.07 2014 në ora 21:17 minuta përmes telefonave 044 ..... ( vërejtje telefon i R. ut ) dhe 044 ..... ( telefon i dëshmitarit në fjalë ) me përmbajtje si në vijim: “ku je shef “ dhe pasi që përshëndeten mes veti Inspektori ( R. u ) e pyet se ku gjendej, i njëjti ( dëshmitari në fjalë ) ia kthen se dola te A.i dhe jam tu pi ni kafe, më pas i akuzuari R. e pyet “se çka po thotë ai burr”, ky ( dëshmitari në fjalë ) e njofton “se kurgjë duke qeshur, më pas inspektori tani i akuzuari R. i thotë se “ ke tu i shku kamioni nashta po zalli, ke tu i shku për ufla, bile edhe kamioni ka mujt me i shku, më pas fillon duke qeshur me të madhe, më pas inspektori e pyet këtë person, se çka bone ti a mujte me kry punë diçka, naj diçka si for, i njëjti ia kthen duke i thënë : mos po ta kryen naj njo duke i rezervuar, më pas inspektori i thotë: valla ai pshtoj për pak qaj shoqi qatv, më pas ky personi i thotë : është burr i mirë, ndërsa inspektori i thotë : valla po po mu dasht me qu atje njo të mirë dhe kryti punë deri të ngojnë”. Më tutje prokurori e ballafaqon dëshmitarin në fjalë me përmbajtjen e transkriptit lidhur me bisedat telefonike të bëra mes të akuzuarit R. dhe këtij dëshmitari më datën 03.07 2014 rreth orës 12:41 minuta “ ...inspektori R. e pyet dëshmitarin në fjalë se “a kishte kryer diçka punë rreth një muhabeti apo letra të doganës që kishin biseduar më herët, ... më pas inspektori i thotë : shiqo ti nëse mundesh e merr diçka Bujanovc- Muçivërc apo i thotë ti blej një herë një kamion zall sa për mi siguruar do letra, tani e shfrytëzon të njëjtin dokumentacion, inspektori e sugjeron duke i thanë se nuk ka lidhje ta kesh njëherë dhe i thu se e kam blerë prej atij edhe tana shnosh, merre një herë edhe pak punë duke i thënë se ska lidhje personi NN ( vërejtje : dëshmiari në fjalë ) i thotë aha okej flm u kry pra”. Në pyetjen e prokurorit të shtetit dëshmitari deklaroi se përmbajtja e transkriptit është e vërtetë dhe se ky ka qenë i obliguar që të siguroj zhavor për djalin e axhës – S. Th., të cilin e ka furnizuar me zhavor për ngritjen e fermës në fshatin Muçivërc, dhe se sigurimi i dokumentacionit valid ka qenë i nevojshëm sepse ngritja e fermës së kushëririt tim ka qenë donacion dhe se ka qenë më se e detyrueshme të faktohet me dokumentacion përkatës. Nga eksploatimi i zhavorit duke u nisur nga ajo që kem zhvilluar biseda me R. un as nga unë e as nga vëllau im nuk ka përfituar kurrëfarë dobie pasurore.

Nga kjo bisedë telefonike rezulton se kinse me dëshmitarin S. Th. të cilin e ka djallë të xhaxhait për ndërtimin e një ferme si donacion nga granti dëshmitari Sabri Thaçi janë marrë vesh që t’ia transportoj zallin me kamion të kompanisë Imrani Commerce mirëpo zallin për shkak të dokumentacionit që i nevojitet atij për ta arsyetuar në Ministrin përkatëse do ta merr tek kompania “ A. D.” siç janë marrë vesh përmes telefonit i akuzuari R. dhe pronari i A. D. R. V.. Nga raporti policor i datës 08.07 2015 rezulton se nga policia është ndaluar automjeti transportues MAN me targa 629 KS 127 i ngarkuar me 15

metra kub zhavor dhe se policia e ka njoftuar inspektorin R. L.në i cili ka qenë në vend të ngjarjes dhe zalli nuk i është marrë dëshmitarit Sh. Th. kinse ka paseduar dokumentacion valid sepse firma ka licencë dhe ajo sasi është marrë te kompania A. D. në Crep – Dheu i Bardhë. Kjo rërë ka qenë duke u dërguar te ferma në Muçivërcë tek kusheriri i tij S. Th. me sa e din ai me dokumentacion të rregullt dhe me dokumentacion të rregullt doganor.

Duke pasur parasysh transkriptin me përmbajtje si më lart të bisedës telefonike mes të akuzuarit R. dhe dëshmitarit Sh. të datës 03.07 2015 dhe më 07.07 2014, **pikërisht i akuzuari R. e ka udhëzuar dëshmitarin Sh. Th. se si mund të siguroj dokumentacion jo valid ose se si mund ta shfrytëzoj dokumentacionin e mëhershëm por që në momentin përkatës nuk është valid kur ta ndal policia,** ashtu edhe dëshmitari Sh. Thaçi ka vepruar edhe në rastin konkret duke ia dërguar zallin kusheririt të tij Sabri Thaçi, e këtë e ka liruar kur ka dalë në vend të ngjarjes ku e ka ndal policia pikërisht i akuzuari R. edhe pse nuk ka poseduar dokumentacion valid për transportimin e rërës dhe zhavorit për arsye se :

-dokumentacionin valid për një kamion transportues me 15 metra kubik dëshmitarit Sabri Thaçi nuk ia ka dërguar kompania A. D., e kjo vërtetohet edhe me ekspertizën financiare sipas të cilës vërtetohet se këtij personi me emrin Sabri Thaçi nuk i ka dërguar kompania A. D., edhe pse ky dëshmitar S. Th. ka deklaruar se nuk e din se Sh. Thaçi a ia ka dërguar dokumentacionin valid për zallin e marrur nga kompania A. D. të cilën ia ka shitur atij, edhe pse dokumentacioni valid i është nevojitur për ta arsyetuar donacionin për fermën e tij, me arsyetim se nga kompanit tjera ka siguruar zall me dokumentacion për ta arsyetuar donacionin nga Ministria.

**Mbi këtë bazë gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari R. i ka keqpërdorur autorizimet e tij si person zyrtar – inspektor komunal duke e udhëzuar dëshmitarin Sh. Th. sesi të siguroj ose të shfrytëzoj dokumentacion jo valid për transportimin e rërës dhe zhavorit por edhe duke e liruar kamionin transportues kinse posedon dokumentacion valid për transportimin e rërës dhe zhavorit deri tek shtëpia e dëshmitarit S. Th. në Muçivrc, Komuna e Kamenicës më datën 08.07 2014 siç rezulton nga raporti policor i administruar si provë materiale, duke i siguruar dobi financiare operatorit I. C. kompani kjo e vëllait të dëshmitarit Sh. Th.. Vlera e dobisë pasurore është 225 Euro, pasi që kamioni transportues ka pas të ngarkuar 15 metra kub rërë përkatësisht zhavor, dhe sipas faturës së lartëcekur që kompania A. D. ka shitur rërë një metër rërë ka kushtuar 18 Euro.**

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari R. duke e keqpërdorur detyrën përkatësisht autorizimet zyrtare ka tejkaluar autorizimet e tij duke e liruar një kamion transportues të ngarkuar me rërë përkatësisht zhavor në emër të personit A. me mbiemër të panjohur për gjykatën, por pa dokumentacion valid. Mbi këtë bazë sipas vendimit të Qeverisë së vendit por edhe marrëveshjes së bashkëpunimit me numra dhe data të lartcekura personat fizik por edhe ata juridik që nuk posedojnë dokumentacion valid për eksploatimin e rërës dhe zhavorit apo që nuk e posedojnë dokumentacion unik doganor përfshirë edhe pëlqimin mjedisor nga Ministria përkatëse e vendit, detyrimisht duhet të ju konfiskohet edhe mjeti transportues dhe mjetet tjera përkatëse. Këtë nuk e ka bërë i akuzuari R.. Këtë gjykata e ka vërtetuar përmes transkriptit të nxjerr nga biseda telefonike mes të akuzuarit R. dhe dëshmitarit Sh. Th. me përmbajtje si në vijim :

transkriptet e bisedës telefonike më datën 07.07 2014 në ora 21:17 minuta përmes telefonave 044 231-000 ( vërejtje telefon i R. ut ) dhe 044 244-105 ( telefon i dëshmitarit në fjalë ) me përmbajtje si në vijim: “ku je shef “ dhe pasi që përhëndeten mes veti Inspektori ( R. u ) e pyet se ku gjendej, i njëjti ( dëshmitari në fjalë ) ia kthen se dola te A. dhe jam tu pi ni kafe, më pas i akuzuari R. e pyet “se çka po thotë ai burr”, ky ( dëshmitari në fjalë ) e njofton “se kurgjë duke qeshur, më pas inspektori tani i akuzuari R. i thotë se “ ke tu i shku kamioni nashta po zalli, ke tu i shku për ufla, bile edhe kamioni ka mujt me i shku, më pas fillon duke qeshur me të madhe, më pas inspektori e pyet këtë person, se çka bone ti a mujte me kry punë diçka, naj diçka si for, i njëjti ia kthen duke i thënë : mos po ta kryen naj njo duke i rezervuar, më pas inspektori i thotë: valla ai pshtoj për pak qaj shoqi qaty, më pas ky personi i thotë : është burr i mirë, ndërsa inspektori i thotë : valla po po mu dasht me qu atje njo të mirë dhe kryti punë deri të ngojnë”. Nga kjo përmbajtje e transkriptit i cili përpunohet në tërësi me përmbajtjen e dëgjuar të CD e cila është riprodhuar gjatë shqyrtimit

**gjqësor, duke mos u kundërshtuar nga i akuzuari rezulton se i akuzuari ka tejkualuar autorizimet zyrtare si inspektor komunal duke i sjellur dobi materiale këtij personi me emrin A. mbiemërin e të cilit nuk e ka treguar as i akuzuari gjatë mbrotjjes së tij e as dëshmitari Sh. Th., duke u arsyetuar se kinse ky person nuk ekziston por gjatë bisedës telefonike të datës 07.07 2014 mes tyre kanë bëlërë vetëm hajgare., edhe pse këtë emër e përmend edhe një dëshmitar tjetër si person përgjegjës i operatorit Besi Com, duke mos e treguar mbiemrin e tij, edhe pse i akuzuari në fjalë sipas transkriptit ka biseduar me te, mirëpo gjykata në mungesë të provave për të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë nuk e ka përfshirë në veprimet inkriminuese të akuzuarin edhe për këtë kompani.**

**Vlen të theksohet se duke e liruar mjetin transportues të ngarkuar me rërë në sasi prej 18 metra kub pronar i të cilit është personi me emrin A., edhe pse nuk ka poseduar dokumentacion valid për transportimin e rërës dhe zhavorit, të njëjtit i ka siguruar dobi materiale në mënyrë të kundërligjshme, në shumë prej 225 Euro ( 18 metra kubik x 18,00 Euro për një metër kubik sipas faturës së lartcekur të cekur më lart në ekspertizën financiare = 225 Euro ).**

**Gjykata në mungesë të provave për të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka keqpërdor autorizimet publik si person zyrtar edhe ndaj kompanive tjera, të përfshira në përshkrimin faktik të veprës penale në aktakuzën lëndore edhe atë të : Xh. T., K. C., K. C. dhe B. C. përfshirë edhe A. D., këto kompani i ka mënjanuar nga përmbajtja e aktit akuzues të paraqitur nga Prokuroria, edhe pse të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndore. Gjykatës nuk i janë ofruar prova të mjaftueshme dhe të lejuara për të vërtetuar involvimin e të akuzuarit në veprimet inkriminuese përkritazi me operatorët e lartcekur edhe pse përkritazi me kompanin A. D.gjykata ka dhënë arsyetim të gjerë, duke mos gjetur prova të mjaftueshme të të akuzuarit përkritazi me këtë operator ekonomik, por as për operatorin ekonomik B. C., për të cilën gjykata ka dhënë arsyetimin përkatës më lart në këtë arsyetim të aktgjykimit. Sa i përket operatorëve tjerë të cekur më lart, vetëm në bazë të raporteve policor pa prova tjera shtesë, gjykata nuk ka mundur që të vëretoj përtej dyshimit të bazuar mirë se edhe përkritazi me këta operator i akuzuari ka ndërmarr veprime inkriminuese duke e keqpërdor detyrën zyrtare ose autorizimet publike si person zyrtar përkatësisht inspektor komunal në kuadër të Komunës së Kamenicës.**

Vlen të theksohet se gjykata e ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit Nazif Hajrizi për ndryshe komandant i SP në Kamenicë, i cili gjendjen në terren në Komunën e Kamenicës e ka paraqitur katastrofale nga eksploatimi i pakontrolluar i rërës dhe zhavorit duke u degraduar territori i komunës së Kamenicës për shkak të mos plotësimit të vendeve të eksploatuara sidomos tokave bujqësore për skaj lumit Morava përkatësisht brigjeve të tij por edhe të shtratit të këtij lumi, duke ju mundësuar që ta ushtrojnë veprimtarin e tyre në kundërshtim me vendimin e Qeverisë, duke e aprovuar në pjesën dërmuese sepse e njëjta përmbajtësisht përputhet me provat tjera të administruara. Mirëpo, të njëjtin nuk e ka pranuar në pjesën tjetër e cila ka të bëjë me ndalimin në tërësi të eksploatimit të rërës dhe zhavorit sipas vendimit të Qeverisë, sepse edhe Marrëveshja e bashkëpunimit është lidhur në bazë të Vendimit të Qeverisë nga akterët e lartcekur duke përfshirë edhe Ministrin e mjedisit dhe planifikimit hapësiror për të cilën është dhënë më lart arsyetim përkatës dhe i mjaftueshëm duke shtuar se kjo marrëveshje nuk është në kundërshtim me vendimin e Qeverisë dhe e ka vlerën e saj juridike ndaj operatorëve ekonomik të cilët kanë vazhduar eksplatin e rërës dhe zhavorit në bazë të kushteve të kërkuara me këtë marrëveshje.

Me provat tjera të elaboruara më lart, sidomos të përmbajtjes së transkripteve të nxjerra nga bisedat telefonike mes akterëve – të të akuzuarit dhe operatorëve si eksploatues të rërës dhe zhavorit, duke përfshirë edhe përmbajtjen me zë të dëgjuar përmes ekraneve në gjykatore nga CD-et e siguruar në procedurë ligjore, por edhe akteve shkresore policore dhe deklaratave të dëshmitarëve dhe të provave tjera materiale gjykata ka vërtetuar se i akuzuari në cilësi të përgjegjës të Inspektoratit komunal në Kamenicë ka tejkualuar kompetencat e tij, duke ju ndihmuar në forma të ndryshme operatorët që të merren me eksploatimin e rërës dhe zhavorit sidomos të subjekteve të cekura në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilët kanë operuar në territorin e komunës së Kamenicës, duke ju dhënë instrukcione për eksploatimin ilegal të materialeve inerte, duke i udhëzuar që të njëjtit të pajisen me dokumente fiktive

doganore dhe të natyrave tjera për t'i bishtruar Policisë gjatë transportimit të materialit inert, e me këto veprime i ka siguruar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme subjekteve në fjalë edhe pse me prova direkt nuk ka vërtetuar ndonjë dobi të çfarëdoshme të të akuzuarit në fjalë, gjykata ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë involvimin inkriminues të të akuzuarit R. në veprën penale të lartcekur, për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në rastin konkret i akuzuari ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së vendit por edhe të marrëveshjes së lartcekur gjatë periudhës kohore nga data 02. 11 2011 e gjer më 02.11 2014, duke ju siguruar dobi materiale në mënyrë të kundërligjshme subjekteve të cekura në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e degraduar terrenin e komunës së Kamenicës, në shtratin e lumit Morava dhe të lumenjëve tjerë në këtë komunë, në brigjet e saj por edhe në tokat bujqësore duke mos u mbuluar gropat për shkak të eksploatimit të rërës dhe zhavorit edhe pse ky është obligim ligjor sipas nenit 13 paragrafi 1 pika b të ligjit të tokës bujqësore të cekur më lart.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-s përkitazi me të akuzuarin, e si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i akuzuari është i pagjakuar dhe nuk zhvillohet procedurë penale tjetër kundër tij, se është mbajtës i vetëm i familjes duke përfshirë bashkëshorten e tij dhe fëmijët e tij, por edhe sjelljen korrekte të tij në gjykatore, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur. Andaj edhe gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar më lart por edhe rrethanat e lartcekura ka ardhur në përfundim se qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-s mund të arrihet edhe me një dënim minimal me burgim, duke u rehabilituar i akuzuari por edhe parandaluar që në të ardhmen mos të kryej vepra penale të kësaj natyre apo tjera të ngjashme, duke u disiplinuar edhe qytetarët potencial që mos të bien ndesh me ligjin për ndryshe do të ndeshen me pasojat juridike evidente.

Në kuptim të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-s të akuzuarit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar periudha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 24.09 2014 e gjer më datën 19 nëntor 2014.

Pas shpalljes së aktgjykimit kryetari i trupit gjykues në kuptim të nenit 368 të KPP-s ka dhënë një arsyetim të shkurtër duke i udhëzuar palët për të drejtën në ankesë.

I akuzuari pas shpalljes së aktgjykimit ka kërkuar fjalën dhe pasi që i është lejuar ka deklaruar se gjykatës i propozon që dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve është i pëlqimit që t'i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Trupi gjykues pasi që është tërhequr për vendosje ka aprovuar propozimin e të akuzuarit dhe me pëlqimin e tij shprehimisht të dhënë pas shpalljes së aktgjykimit, dënimin me burgim e suspendon në kuptim të nenit 47 të KPRK-s duke ia zëvendësuar të njëjtin me dënim me gjobë në shumën prej dymijë ( 2,000 ) Euro , duke e detyruar të akuzuarin që këtë shumë ta paguaj me katër këste të barabarta për katër muaj, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi edhe atë prej nga 500 Euro në muaj, mirëpo nëse eventualisht i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s i njëjti i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 100 dite, i cili dënim duhet të ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së ftesës për mbajtjen e dënimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Për arsyet e lartcekura gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha tiparet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-s.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-s përkitazi me të akuzuarin, e si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i akuzuari është i pagjakuar dhe nuk zhvillohet procedurë penale tjetër kundër tij, se është mbajtës i vetëm i familjes pasiqë bashkëshortën tanimë e ka të vdekur, por edhe burim të vetëm për ekzistencën e familjes së tij e ka pagën mujore edhe pse tanimë është i suspenduar përkohsisht nga puna dhe detyrat e punës, por edhe sjelljen korrekte të tij në gjykatore, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur. Andaj, edhe gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar më lart por edhe rrethanat e lartcekura ka ardhur në përfundim se edhe me një dënim minimal tanimë të zëvendësuar në dënim me gjobë mund të

arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, duke e rehabilituar të njëjtin por edhe parandaluar që në të ardhmen mos të kryej vepra penale të kësaj natyre apo vepra tjera të ngjashme, meqë tanimi sipas nenit 93 paragrafi 2 të KPRK-s Gazeta zyrtare e republikës së Kosovës nr. 2/ 14 janar 2019 si dispozitë më e favorshme sipas fuqisë ligjore për të të akuzuarin dënimi me gjobë nëse eventualisht bëhet i plotfuqishm ky aktgjykim nuk prodhon pasoja juridike ndaj të akuzuarit. Në të njëjtën kohë me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit edhe pse çdo dënim është individual do të ndikohet në disiplinimin e qytetarëve potencial duke i parandaluar që mos të bien ndesh me ligjin. Në kuptim të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-s të akuzuarit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar periudha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 24.09 2014 e gjer më datën 19 nëntor 2014. Pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit n368 të KPP-s janë udhëzuar për të drejtën në ankesë. Për kërkesë pasurore juridike gjykata nuk ka vendos pasi që një kërkesë e tillë nuk është parashtruar para gjykatës lidhur me këtë lëndë penale.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor ka vendosur në kuptim të nenit 454 të KPP-s.

Për arsyet e lartcekura u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr. 11/2020, më datën 09 nëntor të vitit 2020**

**Sekretarja juridike,**  
Kadrije Zymeri

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Aziz Shaqiri, d.v.

**Udhëzim për mjetin juridik** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet **ankesë** në **Gjykatën e Apelit – Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda**, në afat prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditëve nga dita e pranimin të ekzemplarit të të njëjtit.

Ankesa i dorëzohet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme në kopje të mjaftueshme për gjykatë dhe palën kundërshtare.